

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5458
E hënë, 23 prill 2018
çmimi 0.40 €

Limaj në Itali: Liberalizimi, më së largu në fund të vitit

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

VELI NOCAJ, FIGURË MADHËSHTORE E UÇK-së F. 10

Erald SELCA

USHTRIMI I FSK-SË 'SHQIPONJA 6' SJELL NË KOSOVË 12 SHTETE ME TRUPAT E TYRE USHTARAKE F. 7

VINCA THOTË SE QEVERIA HARADINAJ ËSHTË JETËSHKURTËR F. 6

JAVË E NXEHTË, DERI NË 26 GRADË F. 6

EKONOMI

TERMOCENTRALI 'KOSOVA E RE', PROJEKT I PARTNERITETIT PUBLIKO-PRIVAT F. 8

MINISTRI HAMZA MERR MBËSHETJEN AMERIKANE PËR ZHVILLIMIN E KOSOVËS F. 9

KULTURË

GJERMANIA TASHMË NJË VEND TIPIK MULTIKULTUROR F. 12

Nga Mimoza KELMENDI

SPORT

'ELITA' MBLEDH MEDALJET NË GJIMNASTIKË F. 13



FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERIM KUÇI ■ FAQE 4-5

LDK-ja s'ka fuqi ta rrëzojë Qeverinë

Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuçi, e ka quajtur joserioze iniciativën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për mbajtjen e tryezës me partitë politike për temat kombëtare, ku një ndër pikat është edhe caktimi i një date për zgjedhje të reja. Ai ka thënë se

AAK-ja nuk do të jetë pjesë e kësaj konference meqë paraprakisht është dashur përgatitje më e mirë dhe koordinim më i madh. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kuçi ka deklaruar se LDK-ja me këtë parapërgatitje e ka dëmtuar procesin e arritjes së një lloj konsensusi. Sipas

tij, arritja e konsensusit për tema kombëtare është i nevojshëm, por jo në këtë formë. Sa iu përket zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, Kuçi ka thënë se ato do të mbahen në vitin 2021. Ai ka vlerësuar se LDK-ja është e pafuqishme për ta rrëzuar Qeverinë

Zyrtarët qeveritarë premtajnë se Kosova do të jetë vend i pastër

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) të dielën, me rastin e Ditës Botërore të Tokës, ka organizuar një aktivitet në Komunën e Rahovecit. Ministria e MMPH-së, Albena Reshitaj,

në apelin e saj për mbrojtjen e tokës, ka thënë se Kosova mund të bëjë shumë për mbrojtjen e tokës. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë thirrje për ruajtjen e mjedisit ■ FAQE 8



Pozita pret që platforma për dialog me Serbinë të kalojë në Kuvend

Pritjet e koalicionit qeverisës janë që Kuvendi i Kosovës do ta miratojë platformën shtetërore për finalizimin e dialogut me Serbinë, e cila është miratuar javën e kaluar në Qeveri. Zyrtarët qeveritarë kanë thënë se mirëpresin

propozimet e opozitës rreth kësaj platforme, duke shtuar se me këtë dokument synohet uniteti i spektrit politik në këtë proces. Por, subjektet opozitare parimisht e kanë kundërshtuar këtë platformë, duke e cilësuar të varfër ■ FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat.styro@yukon.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kongresistët amerikanë mbështesin reformat në drejtësi

TIRANË, 22 MARS - Kongresistët amerikanë vlerësuan dhe shprehën mbështetjen e fortë për reformat impresionuese të Qeverisë shqiptare në fushën e drejtësisë dhe sigurisë. Këtë e konfirmoi ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, i cili

po zhvillon një vizitë zyrtare në Uashington.

Gjatë qëndrimit të tij në Uashington, Xhafaj pati një agjendë të ngjeshur takimesh në Departamentin e Shtetit, Kongres, FBI e DEA etj. Në Kongres, fillimisht Xhafaj zhvil-

loi një takim shumë konstruktiv me kongresistin Robert B. Anderholt, më pas takim me një tjetër mik të Shqipërisë, kongresistin Steve King. Ndërsa të shtunën Xhafaj zhvilloi një darkë pune me disa personalitete të njohura për

përvojën e tyre si ligjvënës, në fushën e sigurisë dhe diplomacisë, miq e mbështetës në vite të Shqipërisë. "Një diskutim shumë interesant për sfidat aktuale në fushën e sigurisë kombëtare dhe luftën kundër terrorizmit", shkruan Xhafaj në

rrjetin social "Twitter".

Në këtë vizitë në ShBA ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, shoqërohej nga drejtori i përgjithshëm i Policisë dhe një ekip nga Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit.

Limaj në Itali: Liberalizimi, më së largu në fund të vitit

Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, gjatë një bashkëbisedimi me shqiptarë të Kosovës në Itali, ka bërë me dije se liberalizimi i vizave do të ndodhë më së largu në fund të këtij viti

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka zhvilluar një bashkëbisedim me shqiptarë të Kosovës në Itali. Limaj u ka shprehur mirënjohje dhe respekt për kontributin që kanë dhënë para dhe pasluftës për Kosovën. Ai i ka ftuar shqiptarët që jetojnë në Itali që, siç janë mobilizuar bashkë për lirinë e Kosovës, të mobilizohen edhe për shtetndërtimin e vendit. "E di se ka pasur raste kur mund të jeni zhgënjyer në Kosovë, por vendin e juaj kurrë mos e përzini me pushtetin. Nuk shahet shteti për pushtetin. Nuk ka gjë më të shenjtë sesa shteti. Qeveritë ndërrohen, shteti është i shenjtë. Ne kemi arritur diçka që është dashur qindra vjet angazhime e sakrificë për të ardhur deri këtu jemi sot. Nuk ka dhuratë më të

madhe se ne të gjallët ta përjetojnë lirinë e shtetit. Ka qindra mijëra burra e gra që nuk e kanë pasur fatin ta shohin lirinë e vendit", ka thënë Limaj.

Zëvendëskryeministri Limaj ka theksuar se kombi shqiptar është në një udhëkryq. Ai ka shtuar se në tre vjetët e ardhshëm do të përcaktohet çfarë drejtimi do të marrë kombi. "Asnjëherë kombi i Kosovës nuk ka qenë në pozitë më të mirë sesa jemi sot. Na presin edhe disa sfida të mëdha, sidomos neve në Kosovë. I kemi tre-katër çështje që do t'i japin orientim vendit tonë. Ju ftoj të mos hiqni dorë nga Kosova. Të mobilizohemi e ta zhvillojmë vendin", ka shtuar Limaj.

Limaj ka thënë se pret që në muajin maj ose qershor, Kosova ta marrë vesh datën e liberalizimit të vizave dhe se deri në fund të vitit qytetarët e Kosovës



do të lëvizin lirshëm në Zonën Shengen.

Ndërkaq kryetari i Nismës Socialdemokrate për Diasporë, Kadri Gervalla, ka thënë se mërgimtarët kanë nevojë të jenë më afër institucioneve të Kosovës. Gervalla më pas ka

shpalosur një serë kërkesash për Qeverinë e Kosovës. "Ne kemi kërkuar që drejtorët gjithandej nëpër qendra kulturore të jenë nga mërgata dhe jo të vijnë nga Kosova. Investimet nga diaspora të kenë lehtësira doganore dhe të mos ketë shërbime burokratike,

por lehtësira", ka thënë Gervalla. Kërkesë tjetër e diasporës ai ka thënë se është themelimi i një banke të diasporës.

Në këtë vizitë Limaj u shoqërua edhe nga zëvendësministri i Tregtisë dhe Industrisë, Faton Thaçi.

Ligji për gjuhët, peng i Ivanovit

SHKUP, 22 PRILL - Një muaj e gjysmë nga miratimi i tretë i Ligjit për përdorimin e gjuhëve, presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov, nuk ka ndërmend të firmosë të njëjtin. Ai mbron qëndrimin se ligji është antikushetues. Nga ana tjetër, juristi Naser Zyberi thotë se në këtë rast vetë presidenti Ivanov po shkel kushtetutën. Zyberi thotë se ekzistojnë disa mënyra

për shpalljen e ligjit në Gazetën Zyrtare. "Por këtë mendim duhet ta japë Komisioni juridikoligjvënës në Parlamentin e Maqedonisë sepse vetëm ai është kompetent që në këtë rast ta bëjë interpretimin e dispozitave ligjore. Në të kundërtën do të duhet të pritët që të bien dakord apo të pajtohen që presidenti ta nënshkruajë ose të priten zgjedhjet e ardhshme, që të



zgjidhet një person tjetër i cili do ta nënshkruajë. Situata krejt e palakmueshme do të ishte edhe një herë që Qeveria të propozojë që nga fillimi ligjin, që Parlamenti më pas ta miratojë", deklaroi Naser Zyberi, analist.

Kreu i ligjvënësit, Talat Xhaferi, thotë se kompetencat e Kuvendit nuk mund t'i cenojë asnjë institucion tjetër dhe se pret që së shpejti ligji të hyjë në fuqi. Xhaferi thotë

se publikimi i ligjit në Gazetën Zyrtare nuk do ta presë presidentin e ri. "Jo, jo, nuk mund të mbetet për zgjedhjet e ardhshme. Gjithsesi se ka procedurë të caktuar, për të cilën duhet të kemi komunikim edhe me faktorin ndërkombëtar, i cili duhet të jetë i informuar. Mendoj se për një kohë të shkurtër do të ketë zgjidhje definitive", tha Talat Xhaferi, kryetar i Kuvendit.

Kukan rithekson mbështetjen për integrimin e Shqipërisë

Tiranë, 22 prill - Eurodeputeti dhe anëtari i Komisionit të Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian, Eduard Kukan, ka përsëritur rekomandimin e Komisionit Evropian për çeljen e negociatave të Shqipërisë me

Bashkimin Evropian. Eurodeputeti Kukan shprehet se ka mirëpritur dhe mbështet rekomandimin e komisionit për t'i hapur negociatat e pranimit me Shqipërinë. "Shpresoj se së shpejti vendi do të ketë një shans

për t'i filluar negociatat dhe për t'i nxitur proceset e reformave", tha ai.

Eurodeputeti Kukan e ka vënë theksin që Shqipëria duhet të bëjë përparime në sundimin e ligjit dhe të ketë rezultate të prek-

shme. "Shqipëria duhet ta ripojtojë përparimin në sundimin e ligjit dhe të vazhdojë të japë rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar", ka thënë eurodeputeti Kukan.



Platforma shtetërore e Kosovës për finalizimin e dialogut me Serbinë ndan pozitën dhe opozitën

Pozita pret që platforma për dialog me Serbinë të kalojë në Kuvend



Pritjet e koalicionit qeverisës janë që Kuvendi i Kosovës do ta miratojë platformën shtetërore për finalizimin e dialogut me Serbinë, e cila është miratuar javën e kaluar në Qeveri. Zyrtarët qeveritarë kanë thënë se mirëpresin propozimet e opozitës rreth kësaj platforme, duke shtuar se me këtë dokument synohet uniteti i spektrit politik në këtë proces. Por, subjektet opozitare parimisht e kanë kundërshtuar këtë platformë, duke e cilësuar të varfër

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 22 PRILL - Pozita pret që platforma shtetërore e Republikës së Kosovës për finalizimin e dialogut me Serbinë të kalojë në Kuvendin e Kosovës pavarësisht prej faktit se opozita e ka kundërshtuar një dokument të tillë.

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se përmes kësaj platforme synohet të arrihet një unitet në mes të subjekteve politike në këtë proces. "Ideja e platformës është që të kemi unitet në mes të gjitha partive politike, atyre që janë në koalicion qeverisës dhe atyre që janë në opozitë, meqë politika e jashtme është një temë që duhet të na bashkojë dhe jo të na ndajë. Temat e interesit strategjik janë tema të të gjithë atyre të cilët janë në politikë, pavarësisht se kush mund të jetë përkohësisht në pushtet dhe në opozitë. Ideja

e platformës është arritja e një konsensusi politik në mes të gjitha partive politike", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka bërë me dije se Kuvendi është institucioni ku duhet të krijohet uniteti për temat kombëtare. "Fakti që platforma është hartuar dhe propozuar nga Qeveria ka të bëjë me atë se çfarë është Qeveria në sistemin tonë kushtetues dhe politik. Qeveria propozon dokumente që janë të rëndësishme sa i takon politikës së jashtme në raport me Kuvendin. Pastaj i takon Kuvendit ta marrë vendimin e fundit dhe ta vulosë këtë platformë. Pra, është Kuvendi i Kosovës vendi ku krijohet uniteti", është shprehur Hoxhaj, duke shtuar se Qeveria mirëpret propozimet e opozitës për këtë çështje. "Qeveria e ka dërguar versionin e parë të platformës, tash është në dorën e Kuvendit se çfarë do të vendosë. Deputetët mund të vendosin për të hequr ndonjë pjesë apo për të shtuar ndonjë pjesë të re në platformë, madje

mund të dalin edhe me propozime të reja dhe aty mund të krijohet një qasje e përbashkët. Politikisht është në rregull edhe si procedurë. Pra, është në rregull që si Qeveria kemi propozuar një platformë e cila duhet të diskutohet dhe të miratohet në Kuvend", ka thënë Hoxhaj.

Mirëpo opozita parimisht e ka kundërshtuar këtë platformë, të cilën Qeveria e ka miratuar dhe më pas e ka proceduar për në Kuvend. Sipas përfaqësuesve të dy partive opozitare, LDK-së dhe Lëvizjes Vetëvendosje, kjo platformë është e varfër.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka vlerësuar se ky dokument nuk është përmbajtësor. "Platforma e re për dialog me Serbinë është e varfër në përmbajtje, nuk definojnë temat, parimet dhe afatet. LDK-ja do të marrë vendim, në konsultim me grupin parlamentar", ka deklaruar Hoti.

Edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Ismajl Kurteshi, ka kritikuar përmbajt-

jen e kësaj platforme duke thënë se ka shumë të meta. "Platforma ka shumë të meta dhe gjëra të cilat janë të papranueshme për ne. Kjo platformë duhet të vijë në Kuvend, ku subjektet politike duhet të përcaktohen për të. Në fakt, platforma për bisedime me Serbinë duhet të jetë shumë më ndryshe nga kjo që është prezantuar dhe miratuar nga Qeveria. Ata po e quajnë platformë, po ky është vetëm një lloj propozimi sepse platforma duhet të përmbajë elemente të tjera. Nuk mund të ketë normalizim të marrëdhënieve në mes të dy vendeve derisa nuk insistohet dhe nuk arrihet që Kosova të pranohet shtet i pavarur nga

Serbia. Prandaj kjo platformë nuk do ta marrë mbështetjen e Kuvendit", ka deklaruar Kurteshi, duke shtuar se ky propozim mund të plotësohet me sugjerimet e subjekteve politike dhe në fund mund të dalë një platformë si duhet. "Partitë politike në Kuvend mund të diskutojnë dhe t'i japin propozimet e tyre për ta plotësuar këtë propozim. Ne si Vetëvendosje ende nuk jemi ulur të diskutojmë se cilat do të jenë propozimet tona, por do t'i kemi sugjerimet në lidhje me platformën e bisedimeve dhe një pjesë e tyre tanimë janë të njohura për opinionin", ka theksuar Kurteshi për gazetën "Epoka e re".

Daçiq: Platforma e bisedimeve e Kosovës, letër pa kurrfarë vlere

Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiq, ka deklaruar se platforma e Qeverisë së Kosovës për bisedime me Serbinë mund të vendoset vetëm në derën e Qeverisë. "Ata mund të miratojnë çfarë të duan, kjo është një letër për përdorim të brendshëm që

mund ta vendosin në derën e Qeverisë në Prishtinë si gazetë ditore", ka thënë Daçiq për "RTS"-në. Sipas tij, kjo platformë është një letër pa kurrfarë rëndësie. "Ne e dimë çfarë ata dëshirojnë që nga fillimi dhe pikërisht për këtë po flasim", ka deklaruar Daçiqi.

Flet për "Epokën e re", Blerim Kuçi

LDK-ja s'ka fuqi ta

Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuçi, e ka quajtur joserioze iniciativën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për mbajtjen e tryezës me partitë politike për temat kombëtare, ku një ndër pikat është edhe caktimi i një date për zgjedhje të reja. Ai ka thënë se AAK-ja nuk do të jetë pjesë e kësaj konference meqë paraprakisht është dashur përgatitje më e mirë dhe koordinim më i madh. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kuçi ka deklaruar se LDK-ja me këtë parapërgatitje e ka dëmtuar procesin e arritjes së një lloj konsensusi. Sipas tij, arritja e konsensusit për tema kombëtare është i nevojshëm, por jo në këtë formë. Sa iu përket zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, Kuçi ka thënë se ato do të mbahen në vitin 2021. Ai ka vlerësuar se LDK-ja është e pafuqishme për ta rrëzuar Qeverinë

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 22 PRILL - Deputeti i Kuvendit të Kosovës, njëherësh sekretar i përgjithshëm i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuçi, ka thënë të dielën se iniciativa e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për mbajtjen e një tryeze me partitë politike është çështje elektorale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se AAK-ja nuk do të jetë pjesë e saj. "Kjo tryezë nuk është serioze. Për tema serioze duhen përgatitje serioze. Në këtë formë se si është bërë nuk e konsiderojmë serioze ftesën e LDK-së për këtë tryezë. Kemi komunikim me partitë politike, kemi komunikim së paku njerëzor në mes vete, mirëpo deri më tani nuk kemi pasur asnjë lloj komunikimi për këtë tryezë prandaj, si e tillë, është joserioze. Çështja e tryezës është më shumë elektorale sesa që ka ndonjë element të rëndësishëm për Kosovën", është shprehur Kuçi. Ai ka deklaruar se LDK-ja me këtë parapërgatitje e ka dëmtuar procesin e arritjes së një lloj konsensusi. Sipas Kuçit, arritja e konsensusit për tema kombëtare është më se i nevojshëm, por jo i kësaj forme. "Dhe arritja e konsensusit nacional kërkon paraprakisht një platformë të përgatitur mirë në mes të partive politike. Do të ishte mirë të arrihet ky konsensus sepse edhe Qeveria po insiston në këtë konsensus para epilogut të dialogut me Serbinë. Konsensusi është më se i nevojshëm, prandaj edhe përpjekjet

duhet të jenë më të mëdha dhe më të koordinuara", ka deklaruar ai.

Sa iu përket zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, Kuçi ka thënë se ato do të mbahen në vitin 2021. Ai ka vlerësuar se LDK-ja është e pafuqishme për ta rrëzuar Qeverinë. Sipas Kuçit, LDK-ja nuk i ka as votat, as vullnetin dhe as guximin për të qenë në pushtet në këtë kohë kur pritet epilogu i dialogut me Serbinë. "LDK-ja është e pafuqishme për ta kërkuar mocionin për rrëzimin e Qeverisë. Po ashtu, është e pavullnetshme për të qenë në pushtet sepse e di që epilogu i proceseve të mëdha nuk do të jetë i lehtë. Vendimet janë të mëdha dhe nuk besoj se kanë dëshirë që në këtë kohë dhe në harmoni me rrethanat që i kanë brenda në parti, të udhëheqin proceset e mëdha për vendin", ka thënë Kuçi.

"Epoka e re": Z. Kuçi, LDK-ja ka paralajmëruar për të mërkurën mbajtjen e një tryeze me të gjitha partitë politike. Do të marrë pjesë AAK-ja?

Kuçi: AAK-ja nuk ka marrë ndonjë vendim për të marrë pjesë apo jo në një tryezë të tillë. Mendoj se gjasat janë të vogla për pjesëmarrje sepse përgatitjet për një tryezë të tillë janë të mangëta. Ne si AAK mendojmë se duhet një përgatitje më e madhe dhe një koordinim më i madh para se të mbahet një tryezë e tillë. Nuk është e nevojshme veç të takohemi, por para se të takohemi është e rëndësishme të përgatitemi dhe t'i japim orientimet tona në mënyrë që të mund të krijojmë një platformë



të koordinimit dhe të konsensusit për çështje kombëtare.

"Epoka e re": Pse AAK-ja heziton të jetë pjesë e tryezës?

Kuçi: Kjo tryezë nuk është serioze. Për tema serioze duhen përgatitje serioze. Në këtë formë se si është bërë nuk e konsiderojmë serioze ftesën e LDK-së për këtë tryezë. Kemi komunikim me partitë politike, kemi komunikim së paku njerëzor në mes vete, mirëpo deri më tani nuk kemi pasur asnjë lloj komunikimi për këtë tryezë prandaj, si e tillë, është joserioze. Çështja e tryezës është më shumë elektorale sesa që ka ndonjë element të rëndësishëm për Kosovën. AAK-ja nuk do të jetë pjesë e aktiviteteve elektorale të partive të tjera. Kjo është çështje

elektorale e LDK-së, duke pasur parasysh edhe problemet që kohët e fundit i kanë shpërthyer përbrenda. Ata po dëshirojnë të japin një orientim tjetërkah.

"Epoka e re": Megjithatë, LDK-ja përmes kësaj tryeze synon arritjen e një konsensusi dhe një marrëveshje politike për tema kombëtare.

Kuçi: Konsensusi kombëtar për tema kombëtare është më se i nevojshëm, por jo i kësaj forme. Dhe arritja e konsensusit kombëtar kërkon paraprakisht një platformë të përgatitur mirë ndërmjet partive politike. Do të ishte mirë të arrihet ky konsensus sepse edhe Qeveria po insiston në këtë konsensus para epilogut të dialogut me Serbinë. Konsensusi është më se i nevo-

jshëm, prandaj edhe përpjekjet duhet të jenë më të mëdha dhe më të koordinuara.

"Epoka e re": Mund të arrihet ky konsensus meqë edhe Qeveria edhe opozita po kërkojnë të njëjtën gjë në forma të ndryshme?

Kuçi: Konsensusi kombëtar çdoherë është i nevojshëm, por duhen parapërgatitje serioze. Po frikësohem se LDK-ja me këtë parapërgatitje për një tryezë të tillë e ka dëmtuar procesin e arritjes së një lloj konsensusi. Po të ishte serioz iniciimi i kësaj tryeze, do të kishte edhe parapërgatitje serioze. Arritja e konsensusit kombëtar kërkon komunikim, seriozitet, koordinim dhe parapërgatitje në mes të gjitha subjekteve politike.

rrëzojë Qeverinë



tën do të komunikonin me mua si sekretar i përgjithshëm i partisë apo me zyrtarë të tjerë në AAK. Sikur të kishte seriozitet, së bashku do të koordinonim një tryezë të tillë për të arritur një konsensus kombëtar. LDK-ja është e pafuqishme për ta kërkuar mocionin për rrëzimin e Qeverisë. Po ashtu, është e pavullnetshme për të qenë në pushtet sepse e di se epilogu i proceseve të mëdha nuk do të jetë i lehtë. Vendimet janë të mëdha dhe nuk besoj se ata kanë dëshirë që në këtë kohë dhe në harmoni me rrethanat që i kanë brenda në parti, t'i udhëheqin proceset e mëdha për vendin. LDK-ja nuk i ka as votat, as vullnetin dhe as gux-

imin për të qenë në pushtet në këtë kohë kur pritet epilogu i dialogut me Serbinë.

"Epoka e re": Në këto rrethana edhe koalicioni qeverisës është i pafuqishëm meqë nuk e ka shumicën e thjeshtë në Kuvend.

Kuçi: Kjo është shumë e thjeshtë. LDK-ja dhe opozita në përgjithësi lë të kërkojnë mocionin për shkarkimin e Qeverisë. Më thjesht se kjo nuk ka. Pse nuk po e ngritin këtë mocion?

"Epoka e re": Ju po thoni se LDK-ja edhe po t'i ketë votat nuk ka guxim ta rrëzojë Qeverinë?

Kuçi: Po në një farë mënyre

ashtu është. Ajo po dëshiron të kalojë një krizë të brendshme duke krijuar një lloj lidhësi si opozitë duke pasur parasysh edhe pozitën e Lëvizjes Vetëvendosje. Pra, LDK-ja po i bën këto për të dëshmuar se është partia e parë opozitare.

"Epoka e re": Sipas kësaj që po thoni, AAK-ja nuk u frikësohet zgjedhjeve të parakohshme?

Kuçi: AAK-ja ka dalë shumë mirë në zgjedhjet e fundit, prandaj nuk kemi pse të frikësohemi. Përveç liberalizimit të vizave që do të ndodhë, jemi në pritje edhe të rezultateve të tjera të Qeverisë. Këto rezultate do të vijnë deri në fund të këtij viti dhe LDK-ja e di këtë, pran-

daj po mundohet disi ta amortizojë.

"Epoka e re": Z. Kuçi, si do të jetë funksionimi i mëtutjeshëm i kësaj Qeverie?

Kuçi: Kryeministri Haradinaj është duke kryer punë të mira, por marketingun nuk e ka të mirë. Pavarësisht prej kritikave të shumta, qeverisja në aspektin strategjik po shkon konform zgjidhjes së sfidave që janë shumë të rëndësishme për Kosovën. Nuk po kemi problem sepse ligjet dhe çështjet e rëndësishme po aprovohen. Por, si parti dhe Qeveri jemi të interesuar të kemi një stabilitet edhe në votë, dhe këtë do ta zgjidhim shpejt.

Deputeti Xhelili: Duhet vullnet politik për ta luftuar korrupsionin

PRISHTINË, 22 PRILL - Krimi i organizuar dhe korrupsioni vazhdojnë ta pengojnë zhvillimin e Kosovës, kanë vlerësuar deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe njohës të çështjeve të sigurisë. Sipas tyre, ky lloj kriminaliteti ka depërtuar edhe në institucionet e vendit.

Anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Kuvendin e Kosovës kanë thënë se krimi i organizuar vazhdon të jetë një shqetësim për vendin. Fatmir Xhelili, anëtar i këtij komisioni nga Partia Demokratike e Kosovës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se për ta zvogëluar dukurinë e krimit të organizuar në Kosovë duhet që institucionet të investojnë në zbatimin e ligjeve dhe forcimin e sistemit të drejtësisë. "Duhet vullnet politik dhe këmbëngulësi e instrumenteve të shtetit për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Gjyqësia ka ngecur prapa në drejtim të zbatimit dhe ndëshkimit e atyre personave që kanë thyer ligjin në këtë drejtim. Besoj se edhe Prokuroria duhet të jetë më këmbëngulëse në këtë fushë", ka thënë Xhelili. Ai ka thënë se dhënia e dënimeve të merituar për ata persona që merren me krimin e organizuar



do të ishte mesazhi më i mirë që kjo dukuri të mos jetë shumë e përhapur.

Deputeti Xhelili, po ashtu, ka thënë se edhe politika është e përzier me individë, të cilët merren me këto dukuri. Siç ka deklaruar ai, interesi i madh dhe përfitimet e mëdha nga krimi i organizuar kanë arritur të depërtojnë deri te vijat politike. "Dyshimet ekzistojnë se këto grupe të interesit apo grupe të organizuara kriminale, e kanë në një farë mënyre, në lidhje indi-

rekte apo direkte, mbështetjen e politikës, përndryshe nuk kishin mundur të funksionojnë", ka thënë Xhelili.

Njohësi i çështjeve të sigurisë, Naim Maloku, ka theksuar se gjendja ekonomike dhe mosfunksionimi i shtetit ligjor ndikon që grupet e organizuara kriminale të funksionojnë lirshëm në Kosovë. "Kosova ende është në fazën e ngritjes së kapaciteteve të sigurisë dhe të gjitha këto ndikojnë në krimin e organizuar. Përshtypja në opin-

ion është se nuk ka ndëshkim të krimit dhe korrupsionit (të inkriminuarve dhe të korrup-tuarve). Kosova është vend i vogël, secili e njeh secilin dhe normalisht se jo vetëm nga politika që ka ndikim në gjyqësi, por edhe nga vetë qytetarët", ka thënë Maloku.

Maloku ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se sistemi i drejtësisë në Kosovë është duke çaluar dhe ende, sipas tij, duhet kohë që ai të përmirësohet dhe Kosova vërtet të bëhet shtet ligjor.

"Epoka e re": Në këtë tryezë është paraparë edhe caktimi i datës së zgjedhjeve të parakohshme. Është kjo pika që largon AAK-në nga kjo tryezë?

Kuçi: Zgjedhjet parlamentare e kanë afatin e vet të rregullt. Data e zgjedhjeve është e caktuar. Zgjedhjet mbahen në vitin 2021. Është në rolin e opozitës ta kërkojë ardhjen në pushtet kurdo që i krijohen mundësitë. LDK-ja, duke qenë parti opozitare, në momentin që i ka votat, mund të kërkojë mocion për rrëzimin e Qeverisë.

"Epoka e re": Nuk i frikësoheni ngritjes së një mocioni nga LDK-ja?

Kuçi: Krejt kjo çfarë po bën LDK-ja është çështje elektorale. Po të mos ishte kështu, të pak-

Vinca thotë se Qeveria Haradinaj është jetëshkurtër

PRISHTINË, 22 PRILL - Për profesorin dhe studiuesin Agim Vinca, Qeveria e udhëhequr nga Ramush Haradinaj është jetëshkurtër. Ai ka thënë se duhet të shkohet në zgjedhje të parakohshme parlamentare

për ta ndryshuar gjendjen në të cilën aktualisht është Kosova. Në një intervistë dhënë për "KosovaPress"-in, Agim Vinca ka thënë se korrupsioni, mosrespektimi i ligjit, mungesa e zhvillimit

ekonomik dhe nepotizmi janë sëmundje të rënda që ka Qeveria e Kosovës. Ai ka thënë se qytetarët e Kosovës, si kurrë më parë, nuk kanë qenë më keq se sot, madje ai ka theksuar se Kosova mjerisht

po vdes moralisht. Duke folur për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, ai ka thënë se ky institucion është i papërgjegjshëm për ta kryer misionin për të cilin është themeluar.



Qasje jo e barabartë në shërbimet shëndetësore



Ibrahim Berisha (RFE/RL)

PRISHTINË, 22 PRILL - Përfaqësuesit e Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë kanë bërë me dije se qytetarët nuk kanë qasje të barabarta në shërbimet që ofrojnë institucionet publike shëndetësore. Rastet që janë raportuar në këtë shoqatë kanë qenë kryesisht ndërrimi i listave të pritjes së pacientëve që kanë pasur terminë për operacion, mungesa e barnave esenciale, por edhe qasja jo e barabartë në trajtimin e pacien-

tëve jashtë institucioneve publike shëndetësore.

Kështu ka thënë Besim Kodra, drejtues i Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve. "Ka pasur ankesa nga pacientët për listën e barnave esenciale, për listë të pritjes, që disa lihen të presin, e disa futen pa radhë. Pra, kjo tregon se nuk e kanë qasjen e barabartë. Pastaj problem më madhor e shoh fondin për trajtim jashtë vendit. Kemi pasur ankesa se disa janë dërguar jashtë vendit

e disa të tjerë jo. Në zyrën e ankësive kanë ardhur raste kur pacientët në listë për operim janë hequr dhe është futur dikush tjetër. Pra, nuk është qasja e barabartë mes pacientëve", ka thënë Kodra.

Vetë ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka deklaruar për "Radion Evropa e Lirë" se qasja e pacientëve në shërbime cilësore shëndetësore nuk është e kënaqshme. Por, sipas tij, aktualisht po punohet në drejtim të përmirësimit të

gjendjes. "Me qasje në nënkuptojmë që, përpos ta fuqizojmë mjekësinë primare, po ashtu të konsiderojmë (shqyrtojmë) kualitetin e shërbimeve që mos t'i kemi situatat që ekzistojnë sot që njerëzit të shërbimi mjekësor, pa pasur nevojë të kenë njerëz të njohur, po të kenë qasje të lehtë jodiskriminuese, fer dhe ta marrin shërbimin e merituar. Unë nuk jam i kënaqur me këtë indikator dhe ndryshimi do të krijohet duke i rritur investimet, sis-

temi menaxherial të ndryshohet dhe atëherë do të shohim se ku ka ngecje dhe cili është faktori që po e shkakton ngecjen. Është faktori njeri që nuk dëshiron ta kryejë punën e vet apo është mungesa e aparaturës së caktuar e që do ta blejmë atë, apo nëse nuk kemi mjek të ndonjë lëmi, do ta trajnojmë", ka deklaruar Ismaili. Ndërkaq, nga Zyra e Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Kosovë thonë se gjendja në shëndetësi patjetër që kërkon përmirësim. Ardita Tahirukaj, udhëheqëse e Zyrës së OBSH-së, ka deklaruar se qëllimi i sistemit shëndetësor do të duhej të jetë mbulimi shëndetësor i përgjithshëm. Sipas saj, të gjithë njerëzit mund të kenë qasje në shërbimet cilësore shëndetësore kur kanë nevojë për to, pa u përballur me vështirësi financiare. Tahirukaj ka pohuar se shëndeti është pasuria jonë më e madhe dhe nuk duhet të shihet si një luks, i cili mund të gëzohet vetëm nga më të privilegjuarit. "Ne të gjithë përfitojmë në aspektin social, ekonomik dhe nga ai mjedisor nga një botë, e cila synon shëndet për të gjithë. Është koha që së bashku t'i përshpejtojmë përpjekjet tona për ta arritur qëllimin e përbashkët për mbulim shëndetësor të përgjithshëm edhe në Kosovë", ka theksuar ajo. Për gjendjen në fushën e shëndetësisë ka folur edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Ai ka deklaruar se e sheh gjendjen aktuale në shëndetësi shqetësuese dhe i ka ftuar të gjithë partnerët, vendorë dhe ndërkombëtarë, të ndihmojnë për përmirësimin e këtij sektori.

Javë e nxehtë, deri në 26 gradë

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka njoftuar se vendi ynë do të mbetet nën ndikimin e masave të nxehta të ajrit me presion të lartë atmosferik. Gjatë ditëve të ardhshme këto masa të ajrit me presion të lartë do të ulen duke lëvizur rreth vlerave të normales. "Temperaturat do të jenë për 2-3 gradë mbi vlerat e mesatareve. Si pasojë e temperaturave të larta dhe erërave që po fryjnë në pjesën

perëndimore dhe jugperëndimore të kontinentit, kah mesi i javës ka mundësi të larta që në shumë pjesë të Kosovës të paraqitet pluhuri afrikan, i cili me vete, përpos reshjeve të shiut dhe rrufeve lokale, do të bartë edhe grimca të pluhurit, fenomene të zakonshme në vitet e fundit", është thënë në njoftimin e IHMK-së. Sipas IHMK-së, temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 6-10 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës

parashihet të lëvizin ndërmjet 23-26 gradë celsius. "Indeksi UV mbetet i lartë kështu që nga ora 10-16 mundësisht të jemi më pak në kontakt me rrezet direkte të diellit (kuptohej ky regjim nuk vlen në ditët kur qielli është i mbuluar me re). Do të fryjë erë nga drejtimet e ndryshme, por që dominues parashihet të jetë drejtimi i jugperëndimit dhe shpejtësia e saj do të arrijë deri 9m/s", është theksuar në njoftimin e IHMK-së.



Ushtrimi i FSK-së 'Shqiponja 6' sjell në Kosovë 12 shtete me trupat e tyre ushtarake

Në fillim të muajit maj Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) do ta mbajë ushtrimin 'Shqiponja 6', në të cilin do të marrin pjesë 12 shtete me trupat e tyre ushtarake. Komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, ka thënë se për këtë ushtrim FSK-ja i ka bërë të gjitha parapërgatitjet me partnerët e saj

EPOKA
ERE

M. KOCI

PRISHTINË, 22 PRILL - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re", se në fillim të muajit maj në Kosovë do të mbahet ushtrimi 'Shqiponja 6'. Ai ka thënë se pjesëmarrëse në këtë ushtrim do të jenë 12 shtete me trupat e tyre ushtarake. "Këtë vit jemi pjesë e 11 ushtrimeve fushore që do të ndodhin në rajon dhe më gjerë. Ajo që është më e rëndësishmja, në fillim të muajit maj në Kosovë do ta kemi ushtrimin 'Shqiponja 6'. Pra, është hera e parë që ky ushtrim nuk do të jetë nacional, por internacional. Pjesëmarrëse në këtë ushtrim do të jenë 12 shtete me trupat e tyre ushtarake. Natyrisht se për këtë ushtrim i kemi bërë të gjitha parapërgatitjet me partnerët tanë, ndërsa tani e presim zbatimin e këtij ushtrimi", ka thënë

Rama. Ai ka bërë me dije se FSK-ja merr pjesë në shumë ushtrime të përbashkëta, qofshin ato rajonale apo globale. "Në kuptimin profesional ne kemi arritur progres të jashtëzakonshëm. Është konstatim i përgjithshëm se FSK-ja është një forcë kredibile dhe gjithëpërfshirëse. Kur themi gjithëpërfshirëse, i bie se kemi më tepër se 11 për qind të pjesëtarëve të FSK-së nga minoritetet", ka thënë ai.

Komandanti i FSK-së ka treguar se edhe këtë vit i kanë kushtuar rëndësi rekrutimit të pjesëtarëve nga minoriteti serb. "Kemi arritur që mbi pesë për qind të pjesëtarëve që shërbejnë në FSK të jenë nga minoriteti serb. Në bazë të këtij angazhimi kemi arritur që tani në brendi të FSK-së t'i kemi të përfshira të gjitha minoritetet nga secila pjesë e territorit të Kosovës", ka thënë gjeneralletenant Rrahman Rama. Ai ka theksuar se FSK-ja ka një mandat dhe një mision në



bazë të ligjit dhe Kushtetutës së Kosovës.

Rama ka pohuar se duke u bazuar në mandatin dhe misionin e saj, FSK-ja është duke i kryer detyrat ashtu siç i ka të planifikuara në bazë të ligjit, Kushtetutës dhe rregullores së saj. "Gjatë kësaj periudhe i kemi kushtuar rëndësi të jashtëzakonshme ngritjes profesionale brenda FSK-së, mbajtjes së kapaciteteve aktuale që kemi, duke filluar prej çminimit, kërkim-shpëtim, mbrojtjes

kimike-biologjike, aktiviteteve xhenerie, por edhe zhvillimit të njësive brendapërbrenda që i kemi në mbështetje të këtyre kapaciteteve. Po ashtu, jemi mirë edhe me pajisjet individuale dhe kolektive. Gjithashtu, qëndrojmë mirë edhe zhvillimin profesional të pjesëtarëve qoftë brenda institucionit nëpërkurset tona specialistike për fusha të caktuara, qoftë me përkrahjen e jashtëzakonshme të partnerëve tanë në kuptimin e ngritjes profesionale të FSK-së",

ka thënë Rama.

Sipas Barometrit Kosovar të Sigurisë të publikuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Forca e Sigurisë së Kosovës në anketimin e qytetarëve në fundin e vitit 2017 ka dalë e para me 78 për qind, ndërsa sipas rajoneve ka dalë që qytetarët e rajonit të Mitrovicës, të pjesës jugore, e besojnë më së shumti FSK-në, në shkallën 86 %, ata të Prishtinës, me 84 % pasuar nga ata të Pejës e me radhë.



Nderohen personat që gjatë luftës rregulluan armët e UÇK-së

SKENDERAJ, 22 PRILL (ER) - Të dielën është përvuar pllaka përkujtimore në Likoc të Skenderajt për nder të gjashtë aktivistëve që në kohën e luftës nga viti 1995 deri në vitin 1999 kanë rregulluar armët e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Musli Asllanaj, shef i sektorit të armëve, në shtëpinë e të cilit punoheshin dhe rregulloheshin armët, ka thënë se në atë kohë

kanë rregulluar që nga pistoletat deri te topat, por kanë rregulluar edhe bomba. Gjithashtu, në këto pllaka janë edhe emrat e Bajram Ibrahimit, Selim Avdyilit, Ismet Gjinoftit, Osman Hajrizit dhe Enver Bajraktari, të gjithë janë gjallë. Është bërë me dije se ata janë ndihmuar me këshilla profesionale edhe nga komandanti Bekim Berisha, i njohur si "Abeja".

Mbi 400 automjete të 'Elkos grup'-it defilojnë në magjistralen Pejë - Prishtinë

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Të dielën në magjistralen Pejë - Prishtinë kanë defiluar mbi 400 automjete të "Elkos grup"-it. Themeluesi i "Elkos grup" - "Etc", Ramiz Kelmendi, i cili është edhe deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e LDK-së, ka shkruar në profilin e vet në "Facebook", se ky

defilim i veturave të kësaj kompanie po ndodhë në vazhden e përgatitjeve të dokumentarit, si pjesë e shënimit të 30-vjetorit të themelimit të kësaj kompanie. "Në vazhden e përgatitjeve të dokumentarit, si pjesë e shënimit të 30-vjetorit të themelimit dhe punës së 'Elkos grup'-it, mbi 400

automjete të kompanisë defiluan në magjistralen Pejë - Prishtinë. Kënaqësi kur angazhimi ndërdekada shpërblehet me sukses. Meritat i takojnë, familjes, miqve, bashkëpunëtorëve, punonjësve dhe konsumatorëve. Familja 'Elkos' po rritet", ka shkruar Kelmendi.



Zyrtarët qeveritarë premtojnë se Kosova do të jetë vend i pastër

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) të dielën ka organizuar një aktivitet në Komunën e Rahovecit me rastin e Ditës Botërore të Tokës. Ministrja e MMPH-së, Albena Reshitaj, në apelin e saj për mbrojtjen e tokës, ka thënë se Kosova si vend në zhvillim mund të bëjë shumë në mbrojtjen e tokës. Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë thirrje për ruajtjen e mjedisit

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

RAHOVEC, 22 PRILL - Nën organizimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të dielën në Rahovec është shënuar Dita Botërore e Tokës me moton "Një botë pa ndotje të plastikës". Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në apelin e saj për mbrojtjen e tokës, ka thënë se Kosova si vend në zhvillim mund të bëjë shumë për mbrojtjen e tokës. Ajo ka thënë se kjo arrihet vetëm nëse shteti e shoqëria bashkohen forcat. "Jemi këtu bashkë me shumë studentë e nxënës, të cilët me idetë e tyre

kreative na bëjnë të ndihemi të turpëruar nëse ne si institucione nuk punojmë me përkushtim për t'iu dhënë hapësirë dhe mundësi që të na ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit", ka thënë Reshitaj.

Reshitaj ka bërë me dije se ministria që ajo drejton ka një strategji e cila parashihet veprime konkrete për mbrojtjen e tokës, siç është angazhimi për menaxhimin e mbeturinave. "E kemi dhënë një shembull të mirë në Mitrovicë dhe Suharekë, ku për dy ditë kemi arritur t'i asgjësojmë të gjitha deponitë ilegale. Do të doja të mos dalim me gjoba mandatore, por jam e bindur se qytetarët do ta mbrojnë", ka



theksuar ministrja Reshitaj. Ndërkaq kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka falënderuar MMPH-në dhe ministrin Reshitaj për këtë organizim,

duke u zotuar për angazhimin e tij dhe të qytetarëve për një mjedis të pastër. Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e Ditës Botërore të Tokës, në Rahovec është organizuar garë në vizatim dhe pikturë ndërmjet nxënësve të shkollave të kësaj komune.

Tri punimet më të mira kanë marrë mirënjohje nga ministrja Albena Reshitaj.

Po gjatë këtyre aktiviteteve të rinjtë janë nxitur të përdorin materiale të riciklueshme, derisa është bërë edhe promovimi i prodhimeve bujqësore të komunës së Rahovecit.

Gjithashtu, ministrja Reshitaj dhe kryetari i Rahovecit Latifi kanë mbjellë drunjt dekorativë në parkun e qytetit për t'u bashkuar me pas në një aksion të pastrimit, bashkë me shumë vullnetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.

Dita e Tokës në shumicën e komunave të Kosovës është shënuar me aktivitete të ndryshme, të cilat janë orientuar në mbjelljen e fidanëve të rinj, me qëllim që t'i nxisë qytetarët ta mbrojnë mjedisin.

Për herë të parë Dita e Tokës është shënuar më 1970 në Shtetet e Bashkuara.



Haradinaj bën thirrje për ruajtjen e mjedisit

Me rastin e Ditës së Tokës, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se kjo ditë në mbarë globin na shërben për ta ngritur vetëdijen e përgjithshme në mbrojtje të mjedisit, për t'i riparuar dëmet që i janë shkaktuar tokës. "Duke e ruajtur ekosistemin, ajrin e ujin, bjeshkët tona, biodiversitetin, florën dhe faunën, sigurohemi se po e bëjmë më të mirën për vetën dhe brezat që vijnë. Është koha që të angazhohemi të gjithë për një mjedis të shëndoshë, nga i cili varet cilësia e jetës sonë", ka thënë Haradinaj në një deklaratë për medie.

Ministri Hamza merr mbështetjen amerikane për zhvillimin e Kosovës

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, gjatë vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), është prituri në takim pune nga i ngarkuari për çështje të financave ndërkombëtare dhe zhvillim, njëherësh zyrtar i lartë në Departamentin Amerikan të Shtetit, Roland De Marcellus, të cilin e ka informuar për pro-

gresin e Kosovës në fushën e financave, qëndrueshmërinë makro-fiskale dhe menaxhimin e borxhit publik. Po ashtu, Hamza e ka njoftuar zyrtarin amerikan edhe me zhvillimet pozitive rreth buxhetit të shtetit për vitin 2018 si dhe për sfidat me të cilat po përballët Kosova.

Më tutje, ministri Hamza ka falënderuar Qeverinë e

Shteteve të Bashkuara dhe agjencitë e saj, në veçanti të gjithë taksapaguesit amerikanë, për ndihmën dhënë për zhvillimin e Kosovës. Ndërsa i ngarkuari për çështje të financave ndërkombëtare dhe zhvillim, Roland De Marcellus, ka përgëzuar ministrin Hamza për vendosjen e disiplinës financiare dhe për progresin e arritur në të gjitha fushat, duke përf-

shirë edhe financat e Republikës së Kosovës. "Vëmendja dhe ndihma financiare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Kosovën gjithmonë ka qenë dhe do të jetë edhe në të ardhmen në dispozicion për zhvillimin e Kosovës. Edhe sa i përket Ministrisë së Financave për asnjë moment ndihma jonë nuk do të mungojë", ka thënë Marcellus.



Termocentrali 'Kosova e Re', projekt i partneritetit publiko-privat



Ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZhE), Valdrin Lluka, ka thënë se projekti i Termocentralit "Kosova e Re" është projekt i Partneritetit Publiko-Privat (PPP). "Në këtë rast, sikurse edhe në rastin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, sektori privat do të operojë impiantin për 20 vjet, pastaj ia transferon atë sektorit publik pa asnjë kosto", ka thënë ministri Lluka

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 PRILL - Ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZhE), Valdrin Lluka, ka thënë se një ndër pikat kryesore të Strategjisë së Energjisë së Kosovës është zhvillimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike. Ai ka thënë se Qeveria është duke u angazhuar për zhvillim të kapaciteteve të reja gjeneruese nga të gjitha burimet e mundshme që i ka vendi ynë. Lluka ka pohuar se një ndër projektet më të mëdha të kësaj fushe është Projekti për Termocentralin "Kosova e Re". "Politikat ekonomike të Kosovës janë të orientuara për fuqizimin sa më të madh të sektorit privat, andaj edhe për pjesën më të madhe të kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike, vendi ynë ka

bërë përpjekje që investimet të vijnë nga sektori privat. Mirëpo, për t'i arritur të gjitha objektivat ekonomike të Qeverisë së Kosovës çështje kruciale është që fillimisht të arrihet pavarësia energjetike e vendit, si dhe siguria e furnizimit të rregullt me energji elektrike. Për të garantuar pavarësi energjetike dhe për të ofruar siguri në furnizimin me energji elektrike, Kosova duhet t'i zëvendësojë kapacitetet e TC 'Kosova A' me kapacitete të reja gjeneruese", ka thënë Lluka në një shkrim të postuar në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas tij, në përgatitjen e projektit të Termocentralit Kosova e Re (TCKR) Qeveria i ka marrë parasysh me kujdes të gjithë faktorët determinues, duke përfshirë edhe faktorët mjedisorë dhe ata të koston. "Në fakt, për të siguruar financim nga

Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFI) për një termocentral me djegie të linjtit, janë marrë parasysh plotësisht të gjitha alternativat e realizueshme dhe koston e tyre ekonomike. Studimet e shumta që janë bërë në vlerësimin e ndikimeve dhe koston kanë ardhur në përfundim se Termocentrali 'Kosova e Re' në formën që po e zhvillojmë ne, është opsioni me koston më të ulët për të arritur këto qëllime. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh edhe faktorët mjedisorë dhe koston, Qeveria është përcaktuar për Termocentralin 'Kosova e Re' dhe është zgjidhje e nevojshme për periudhën afatgjatë, duke mundësuar pavarësinë dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe duke mundësuar kalimin më të sigurt energjetik nga energjia që varet nga linjiti drejt burimeve të ripërtëritshme të energjisë", ka thënë Lluka. Ministri Lluka ka pohuar se projekti i Termocentralit "Kosova e Re" është projekt i Partneritetit Publiko Privat (PPP). "Në këtë rast, sikurse edhe në rastin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, sektori privat do ta operojë impiantin për 20 vjet, pastaj ia transferon atë sektorit publik pa asnjë kosto. Termocentrali 'Kosova e Re' do

të dizajnohet dhe ndërtohet për një jetëgjatësi operationale prej 40 vjetësh, kështu që Qeveria do të jetë në gjendje të operojë me termocentralin për periudhën e mbetur prej 20 vjetësh. Projekti TC 'Kosova e Re' do të realizohet komplet nga investimet private, pra Qeveria e Kosovës nga buxheti i saj nuk do të shpenzojë asnjë cent për këtë projekt. Investitori privat Contour Global do të investojë tërë projektin, ku nga shumica e përgjithshme do të investojë 30 % të kapitalit të saj, kurse pjesën tjetër investitori do ta sigurojë në formë kredie nga institucionet ndërkombëtare financiare, siç është Banka Botërore, partneri ynë kyç në këtë projekt, me institucionet e saj të brendshme si MIGA, IFC dhe IDA, pastaj Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, BERZh (Republika e Kosovës u bë shteti i 66-të anëtar i BERZh-it në dhjetor 2012). Kështu që, Projekti i Termocentralit 'Kosova e Re' u kualifikua për mbështetje nga BERZh-i, përfshirë mbështetjen financiare), Agjencitë e Kreditimit të Eksportit (ECA), Bankat Ex-Im, kreditorë komercialë dhe institucione potenciale kredituese të furnizuesit", ka shkruar Lluka. Ai ka thënë se në këtë pjesë duhet sqaruar se IRR (Norma e

Brendshme e Kthimit) në kapital është interesi që investitori kërkon ta kthejë për investimin që do ta bëjë në Kosovë. "Shifra e kërkuar nga Contour Global ka qenë në mes të 23 deri në 27 %, kurse në gjatë bisedimeve kemi arritur që këtë ta ulim deri në 18.5 %. Mirëpo, duhet të sqarohet se kjo normë e interesit është e aplikueshme vetëm për 30 % të mjeteve të totalit të projektit, (mjete këto që investitori do t'i investojë nga kapitali i vet), kurse pjesa tjetër do të jenë kredi nga institucionet financiare ndërkombëtare, për të cilat nuk aplikohet IRR. Pra, interesi i këtyre kredive (70 % e totalit të projektit) do të jetë shumë më i ulët, sipas praktikave diku nën 7%", ka thënë Lluka, duke shtuar se Qeveria e Kosovës ka rol kyç për mbikëqyrjen e secilit proces të financimit dhe investimit që investitori do të realizojë në këtë projekt. "Po ashtu, Qeveria e Kosovës është shumë e angazhuar edhe për procesin tenderues që investitori do ta shpallë për përzgjedhjen e kompanisë ndërtuese (inxhiniering, projektim dhe ndërtim). Me këtë ne do të sigurohemi se çdo proces dhe procedurë është bërë në përputhje të plotë me të gjitha aspektet ligjore dhe ekonomike vendore dhe ndërkombëtare", ka thënë ministri Lluka.

Veli Nocaj, figurë madhështore e UÇK-së

Trimi i madh Veli Noci dhjetëra herë barti armatime nga Shqipëria në Kosovë me krahët e njomë rinorë e me vullnet të çeliktë, ishte burrë modest fjalëpakë e atdhetar shembullor

Shkruan: Erald SELCA

Populli shqiptar gjithnjë ka zhvilluar luftëra të drejta me karakter çlirimtar mbrojtës dhe konform së drejtës sonë zakonore, ne kurrë nuk i ramë në qafë askujt, por historikisht luftuam padrejtësitë historike karshi nesh.

Okupatori barbar serb po e mbante Kosovën dhe viset e tjera shqiptare nën okupim mizor në aparteid dhe dhunë sistematike përderisa nuk doli në fillim të viteve '90-ta në skenë kryevepra jonë, projekti shekullor i shqiptarëve - Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) si ushtri e popullit.

Serbia e kuptonte vetëm gjuhën e forcës andaj djalëria dhe vajzëria më e mirë e kombit u rreshtua në UÇK-në tonë, e cila ia ktheu dinjitetin e nëpërkëmbur popullit shqiptar.

Ushtrisë së Zahir Pajazitit, Edmond Hoxhës, Luan Haradinajt, Adrian Krasniqit, komandantit legjendar Adem

Jasharit iu bashkuan edhe shumë trima të paepur si Veli Noci nga Dujaka e Gjakovës, i cili ishte rritur dhe edukuar në një familje me taban kombëtar dhe si familje punëtore me nder të madh gjithandej.

Qysh i ri Veli Noci ishte rritur me ndjenjat më sublime të dashurisë për Shqipërinë, Tropojën, Tiranën, Janinën, me idealin e çlirimit dhe bashkimit kombëtar.

Veliu urrente çizmen vrastare serbe dhe ishte betuar se do t'i luftonte për vdekje ata në momentin kur do të kërciste lufta, dasma e madhe e lirisë sonë të paguar shtrenjtë me gjak brez pas brezi.

I edukuar nga baca Adem, nëna Nuriye, e si nip i të famshmit Haxhi Alisë nga Juniku nuk kishte si të ndodhte ndryshe, strategu, trimi, vizionari Veli Noci u rreshtua nga të parët në UÇK në Dukagjin duke lenë gruan fëmijët e vegjël, motrat, prindërit për ta dhënë kontributin epokal në çlirimin e Kosovës.

Në fillim të vitit '98 e gjejmë në

Glogjan te Ramush Haradinaj në Jabllanicë, Lug të Baranit, në Junik, në Jasiq duke kryer shumë aksione guerile në aksin rrugor Pejë-Deçan-Gjakovë, me njësitet tona, duke iu shkaktuar shumë humbje forcave armike serbe në teknikë dhe njerëz.

Trimi i madh Veli Noci dhjetëra herë barti armatime nga Shqipëria në Kosovë me krahët e njomë rinorë e me vullnet të çeliktë, ishte burrë modest fjalëpakë e atdhetar shembullor. Në një nga ditët në pranverën e 20 vjetëve më parë, më 23 prill të vitit 1998, kolosi Veli Noci, bashkë me trimin e madh Blerim Jonuzaj e dhjetëra bashkëluftëtarë të tjerë, në një pusi e betejë të përgjakshme me forcat serbe, ranë në altar të lirisë në malet e Koshares. Duhet të jemi të vetëdijshëm si popull se me gjakun e Veli Nocit, Blerimit, e mijëra dëshmorëve jemi të lirë të frymojmë shqip, andaj duhet ta çmojmë brez pas brezi amanetin e dalëzotësve të atdheut dhe të punojmë për bashkimin kombëtar.



Theranda shënon Ditën e Tokës, në Reqan u mbollën 50 drunj dekorativë

THERANDË, 22 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka zgjedhur fshatin Reqan të kësaj komune për ta shënuar Ditën Ndërkombëtare të Tokës.

Ai së bashku me disa fëmijë kanë

bërë mbjelljen e drunjve dekorativë. Muharremaj ka theksuar se vetëm së bashku mund të krijojnë të ardhmen me një ambient të bukur. "Anila, Erblini dhe Ardiani janë fëmijët që na ndihmuan në mbjelljen e drunjve dekorativë në Reqan. Si

gjithë fëmijët e tjerë, edhe ata e duan ambientin. Së bashku ne mund t'hua krijojmë të ardhmen me një ambient të bukur", ka thënë Muharremaj, duke bërë me dije se në Reqan banorët dhe bizneset mbollën 50 drunj dekorativë.

Mbillen 800 fidane në kryeqytet

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Komuna e Prishtinës ka shënuar të dielën Ditën Ndërkombëtare të Tokës. Kryetari i kësaj komune, Shpend Ahmeti, së bashku me nxënësit e shkollës "Dardania", kanë realizuar disa aktivitete me rastin e kësaj dite. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Tokës në kryeqytet janë mbjellë rreth



800 fidane, ndërsa gjatë këtij viti në Prishtinë do të mbillen afër 5 000 drunj.

Tahiri shikon nga afër mbjelljen e patates në Vushtrri

VUSHTRRI, 22 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka vizituar të dielën fermerët të cilët po e kryejnë mbjelljen e patates në këtë komunë.

Ai ka bërë me dije se bujqësia është dega kryesore e zhvillimit ekonomik dhe e punësimin në Komunën e Vushtrrisë. "Jemi të bekuar me tokë pjellore dhe me fermerë të



vyeshëm. Do të jemi pranë tyre si qeverisje e re për të ofruar gjithë përkrahjen që mund të ofrojë komuna", ka thënë Tahiri.

Oazë e kujt është Kosova?

- Vija e Teodosit rishfaqet, nga do t'ia mbajnë shqiptarët?



Sylejman KRASNIQI

Ka tri vjet që politika në Kosovë po merret me rehatimin e fqinjëve dhe nuk po i shikon problemet e veta të brendshme. Që nga gjysma e parë e vitit 2015 qeveritë tona bëjnë gara se cila do të jetë më besnike ndaj nënshkrimeve të vëna në Bruksel nga krerët e shtetit tonë. Dhe qeveritë ndërrohen njëra pas tjetrës sikurse "kuleçtë e qirave" me të vetmin qëllim - që të tregohen se cila është më e moderuar se tjetra për përmbushjen e premtimeve ndaj të huajve.

Kurse në fushata parazgjedhore e shtirrin gurmazin duke e premtuar zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e popullatës dhe me përkushtim thoshin se do t'i krijojnë mbi 350 000 vende pune dhe se do të hapin universitete në të gjitha qytetet e Kosovës. Bile pati edhe të tillë që premtuan universitet edhe në Lluzhan të Llapit e në Shtime të rrafshit të Kosovës. Më i sqartë dhe më i besuari nga të gjithë ishte Behgjet Pacolli, i cili premtoi se do ta zhvendosë Universitetin e Prishtinës nga aty. Dhe ky premtim i dhurohej dikujt...!? Por është e sigurt se këtë zhvendosje nuk do ta bënte për hatër të Marecit e as të Kosovës...

Pas zgjedhjeve, partitë bënin turr e vrap se cila do të jetë më me "fat" për të marrë pjesë në tepsinë e qeverisë dhe cila do të tregohej më besnike ndaj të huajve, duke i lënë anash (besa

edhe në harresë) premtimet para zgjedhësve të vet. Vijat e kuqe shkriheshin edhe natën(!) vetëm për ta zënë pritën para tjetrit. Para zgjedhjeve griheshin e vriteshin mes vete e pas shpalljes së rezultateve futeshin në koalicion si miqtë më të mirë. Bile, për t'i zbutur inatet, ndihmonin edhe vëllezërit tanë nga gjaku, por edhe të huajt për miratimin e afrive në koalicion.

Bëri krejt çfarë mundi të bënte dhe një natë vonë, pasi u kthye nga vëllai i madh (dhe me porosi të tij, të kryetarit të Shqipërisë), e mundi veten dhe u fut në koalicion qeverisës për ta "shpëtuar" Kosovën nga kriza qeverisëse!? Pastaj nuk vonoi shumë dhe gati të gjitha partitë që ishin në pritje u radhitën për ta ndarë tortën e qeverisjes së vendit. Tani nuk kishte rregull në ndarjen e tepsisë. Me rëndësi ishte vetëm vullneti dhe dëshira për ta "shpëtuar" vendin nga ngërçi politik dhe përmbushja e premtimeve ndaj miqve tanë të jashtëm.

Tepsia qeverisëse u nda në mënyrën më të çuditshme. Aty nuk pati plotpjesëtim sipas fuqisë së votës, por grabitje të posteve sipas muskujve. U desh që të ngopen të gjithë të uriturit për pushtet. Kryeministri e filloi punën me stupc në krah! Menjëherë e shkarkoi komisionin e Murat Mehës për demarkacionin. E caktoi një komision profesionistësh. Opinioni i gjerë mendoi se, më në fund, do të kthehet e mbara në këtë vend. U përgatitën planet dhe strategjia për miratim në Kuvend të demarkacionit, por nuk i kishin punët mirë me numra. Ato duhej të siguroheshin, përndryshe do të bëheshin horë para botës. Besa e dhënë të huajve nuk bën të shkelet. U desh të investohej shumë në ndërhyrje në njëren

parti kryeneçe të opozitës në mënyrë që të sigurohej një votë e vetme për të kaluar në Kuvend. Paraja e çon ujin përpetetë, thoshin të parët tanë. Kur kësaj ia shtojmë edhe shantazhimin dhe kolonën e pestë brenda, sukcesi ishte i garantuar.

Pati paralajmërim partia kryeneçe nga kryetari i Kuvendit kur ai iu kërcënua botërisht në sallën e Kuvendit se "...do ta shihni ju në muajin janar se çka do të ndodhë me ju". Dhe vërtet ashtu ndodhi. Trembëdhjetë deputetë e lëshuan rrugën e opozitës dhe iu mbathën pushtetit në mënyrën më dinake të mundshme. Kurse partia paqësore rrinte me një këmbë për ta votuar demarkacionin sepse kishte hise edhe ajo në këtë marifet, edhe pse ishte në opozitë. Kishim "investuar" shumë mund në demarkacion nëpërmjet Murat Mehës dhe ekipit të akademikëve. Kishin humbur shumë kohë sa ishte kryeministër kryetari i tyre i partisë. Pas disa seancave të Kuvendit dhe pas disa ndërprerjeve nga gazi lotsjellës, demarkacioni u miratua me një votë të paguar shtrenjtë.

Miratimi i demarkacionit në kushte të jashtëzakonshme përngjau shumë edhe me zgjedhjen e kryetarit të Kosovës, Hashim Thaçit, në fund të vitit 2014 dhe me zgjedhjen e kryetarit të Shqipërisë, Sali Berishës, në vitin 1996. Pra, si po duket, ne po u dashka që çdo gjë ta bëjmë në situata të jashtëzakonshme. E jashtëzakonshmeja neve do të na bëhet e zakonshme. Sepse që nga 2 prilli i vitit 1981 e deri më 11 qershor të vitit 1999 kemi qenë në gjendje të jashtëzakonshme. Tashmë jemi bërë imunë në të jashtëzakonshmen, kurse e zakonshmeja na bëhet e padu-

rueshme dhe e pazakontë.

Java që e lamë pas ishte shumë e bujshme për politikën dhe popullin e Kosovës. Ndodhën ngjarje të paparashikuara për opinionin. Të tilla ishin edhe për një pjesë të politikës, por pjesa tjetër i kishte parapa dhe dyshohet se edhe i kishte përgatitur skenarët për këto ngjarje. Tre faktorët kryesorë të pushtetit thuaja se nuk kishin koordinim mes vete, ose bëheshin si të tillë!? Mundoheshin se cili cilit do t'ia lëshonte në dorë pataten e nxehtë.

Kështu, më 26 mars ndodhi arrestimi i Marko Gjuriqit, drejtorit të së ashtuquajturës zyrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë. Arrestimi u bë në mënyrë mjaft spektakulare. Kjo ndodhi të nesërmen e darkës së shtruar mes kryetarit të Serbisë dhe kryetarit të Kosovës. Për këtë arrestim nuk kishin dijeni disa segmente të pushtetit! Ose ndoshta ashtu vetëm paraqiteshin para opinionit!? Gati sa nuk u ngatëruan edhe kompetencat mes kryeministrit dhe zëvendësve të tij. Koha e kurdisur e vizitës së Marko Gjuriqit në Kosovë dhe spektakli i arrestimit të tij, të bën të dyshosh në ndonjë skenar të mirëpërgatitur nga njëra palë ose nga të dyja palët bashkë. Se çka pritet dhe çka fshihet pas këtij operacioni spektakular mbetet të shihet. Në opinion mendohet se janë dy arsyet e këtij spektakli: arsyeja e parë është që të harrohet demarkacioni dhe të mos përmendet liberalizimi i vizave (nën tryninë e të cilit u mundua të bindet opinioni dhe deputetët për miratim të demarkacionit) dhe arsyeja e dytë mund të jetë trysnia për ta filluar formimin e "Zajednicës". E, si po shihet, qëndrojnë të dyja këto parashikime.

Në vazhden e befasive, vetëm tri ditë pas rastit të arrestimit të Marko Gjuriqit, u deportuan, u ekstraduan, u kidnapuan, u arrestuan, ose u grabitën nga shërbimet sekrete turke për në Turqi, gjashtë qytetarë turq të cilët ishin mësimdhënës në Kolegjin "Mehmet Akif" në mënyrën më misterioze. Për këtë rast Qeveria nuk kishte pasur njohuri fare. Prapë faktori politik e shtetëror i Kosovës doli i përçarë dyzash!? Nuk dihej se kush i ka arrestuar e as kush i ka deportuar dhe me leje të cilit organ të shtetit të Kosovës? Dhe kur kryeministri i shkarkoi nga detyra ministrin e Brendshëm dhe drejtorin e AKI-së, erdhi edhe kërcënimi i kryetarit të Turqisë për kryeministrin e Kosovës, njëkohësisht i bëri lëvdën kryetarit të Kosovës për ndihmesën e dhënë për deportimin e qytetarëve turq për në Turqi. Në Kosovë u krijua një kaos politik dhe mediatik i paparë ndonjëherë në këto anë. Flitet se nuk ka ndodhur kurrë në asnjë shtet të botës arrestime dhe deportime të këtij lloji. Kryetari i Kosovës në konferencën për medie, të deportuarit i quan terroristë pa dhënë asnjë fakt të vetëm. Me këtë rast u shkel e drejta elementare e shtetasve turq dhe tanimë nuk mund të parashikohet fati i tyre. Kjo nuk përkon me të drejtën kanunore shqiptare, por as me ndonjë konventë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në manifestimin e Pashkëve në katedralen Shën Nëna Terezë, Dodë Gjergji e tha thelbin e këtij veprimi "Këta që kanë pre mikun në besë, të gatshëm ta dorëzojnë edhe kryeministrin". Për habinë tonë, kryemyftiu i Kosovës Naim Tërnavë nuk e foli asnjë fjalë për këtë ngjarje, edhe pse radha e ka dashtë që ai të prononcohej para Dodë Gjergjit. (Vijon)

Aliu inspektohen punimet në rrugën 'Sali Çekaj'

FERIZAJ, 22 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka inspektuar punimet që po bëhen për asfaltimin e rrugës "Sali Çekaj", e cila ka rëndësi të veçantë për komunitetin e kësaj zone. Gjatë këtij inspektimi punëkryesit kanë njoftuar hollësisht kryetarin Aliu për projektin në fjalë. Me këtë rast, kryetari Aliu është shprehur i

kënaqur me dinamikën e punës dhe cilësinë e punimeve. Ai ka theksuar se Komuna e Ferizajt është e vendosur që çdo projekt infrastrukturor të mbikëqyrë vazhdimisht, veçanërisht në cilësinë e punimeve, për ta siguruar përfundimin me kohë dhe sipas standardeve të projekteve infrastrukurore të filluara.



Trumpi: Përparim dhe shpresë me Korenë e Veriut

UASHINGTON, 22 PRILL - Presidenti Donald Trump thotë se Shtetet e Bashkuara nuk kanë premtuar asnjë lëshim para takimit të planifikuar me udhëheqësin e Koresë së Veriut Kim Jong Un, ndërkohë që Pheniani sapo ka njoftuar se ka reduktuar programin e tij bërthamor. Presidenti amerikan postoi në "Twitter" një koment ku thotë: "Ne nuk kemi hequr dorë nga

asnjë prej kërkesave tona, ndërkohë që ata kanë rënë dakord për çmilitarizimin bërthamor (një gjë e mrekulueshme për botën), për mbylljen e objekteve dhe ndalimin e provave!" Por presidenti pohon se është ende i paqartë rezultati i takimit të tij me udhëheqësin koreano-verior që mendohet se do të zhvillohet në fund të majit apo në fillim të qer-

shorit. Pheniani ende nuk ka rënë dakord ta eliminojë arsenalin e tij bërthamor dhe nuk është deklaruar për çmilitarizimin bërthamor të gadishullit korean. "Kemi ende shumë punë deri në arritjen e zgjidhjes për Korenë e Veriut. Ndoshta çdo gjë do të funksionojë, ndoshta jo. Do ta shohim. Por puna që po bëj tani duhet të ishte bërë me kohë", tha Trumpi.



Irani 'kërcënon' me rinisje të programit bërthamor

Ministri i Jashtëm iranian Mohammad Javad Zarif ka thënë se nëse vjen vendimi nga presidenti Donald Trump, që zyrtarisht të tërhiqen nga marrëveshja, atëherë Irani do të marrë vendime që janë të siguruar në marrëveshje dhe jashtë saj

TEHERAN, 22 PRILL - Ministri i Jashtëm iranian Mohammad Javad Zarif ka thënë se Teherani do ta rinisë programin e tij bërthamor "me shpejtësi më të madhe" nëse Shtetet e Bashkuara tërhiqen nga marrëveshja bërthamore e arritur më 2015. "Nëse vjen vendimi nga presidenti Donald Trump që zyrtarisht të tërhiqen nga marrëveshja, atëherë Irani do të marrë vendime që janë të siguruar në marrëveshje dhe jashtë saj", ka deklaruar Zarif, duke iu referuar marrëveshjes bërthamore.

Ministri i Jashtëm iranian, i cili ndodhet në ShBA për të marrë pjesë në takimin e Kombeve të Bashkuara, ka dhënë një intervistë për televizionin CBS më 22

prill. "Ne kemi një numër opsionesh për vetën tonë dhe ato opsione janë të gatshme, përfshirë edhe opsionet që do ta përfshinin rinisjen në shpejtësi të madhe të aktiviteteve tona bërthamore", ka thënë ai. Megjithatë, Zarif, në një deklaram para gazetarëve më 21 prill, ishte shprehur se Irani nuk po kërkon të krijojë bombë bërthamore.

Por, ai tha se përgjigjja "e mundshme" e Teheranit nëse ShBA-ja heq dorë nga marrëveshja, është ta rinisë prodhimin e uraniumit të pasuruar - një përbërës kyç në prodhimin e armëve bërthamore. "Amerika kurrë nuk është dashur të frikësohet se Irani do të prodhojë bombë bërthamore, por ne do



të vazhdojmë fuqishëm në pasurimin tonë bërthamor", ka theksuar ai.

Irani vazhdimisht ka thënë se programi i tij bërthamor është për qëllime paqësore.

Presidenti Trump ka thënë se Irani po shkel "shpirtin" e mar-

të sanksioneve, në këmbim të frenimit të programit bërthamor.

Trumpi u ka bërë thirrje fuqive evropiane t'i "përmirësojnë" ato që ai i quan "të meta të tmerrshme" të marrëveshjes, duke thënë se kufizime të reja duhet të vendosen ndaj programit bërthamor të Teheranit. Presidenti amerikan ka vendosur 12 majin si afat të fundit për ta përmirësuar marrëveshjen.

Fuqitë e tjera që kanë nënshkruar këtë marrëveshje - Britania, Kina, Franca, Gjermania dhe Rusia - i kanë bërë thirrje Uashingtonit të vazhdojë të qëndrojë në këtë pakt, duke thënë se kjo është mënyra më e mirë për të parandaluar Iranin që të zhvillojë armë bërthamore. Një zyrtar i administratës amerikane u ka thënë gazetarëve se Trumpi dhe homologu i tij francez, Emmanuel Macron, do të bisedojnë për paktin bërthamor gjatë takimit të tyre në Shtëpinë e Bardhë sot (e hënë).

Partitë opozitare ndihmojnë njëra-tjetrën për ta sfiduar Erdoganin

ANKARA, 22 PRILL - Pesëmbëdhjetë deputetë turq nga partia kryesore opozitare CHP kanë shkruar në partinë Iyi, në mënyrë që kjo parti të mund të garojë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare që janë thirrur nga presidenti Rexhep Tajip Erdogan.

Erdogani ka shpallur zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe presidenciale për 24 qershor.



Zgjedhjet e rregullta ishin paraqitur të mbaheshin mbas një viti. Ky njoftim u prit me kundërshtim

nga partitë opozitare pasi ata thonë se Erdoganin synon të ketë një presidencë me fuqi më të mëdha ekzekutive.

Sfiduesi kryesor i Erdoganit po konsiderohet Meral Askener, ish-ministër i Brendshëm, i cili vitin e kaluar ka formuar partinë Iyi.

Autoritetet duhet të vendosin nëse partia e Aksenerit, që ka vetëm pesë deputetë në parlament,

mund të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare.

Prandaj, 15 deputetë nga partia sekulariste CHP i janë bashkuar numrin e duhur në mënyrë që të marrë pjesë në zgjedhje.

Në Turqi partitë me 20 e më shumë deputetë njihen si grupe parlamentare dhe me automatizëm kanë të drejtë të marrin

pjesë në zgjedhje. Partia CHP, pas largimit të këtyre deputetëve, ka 116 deputetë në Parlamentin prej 550 ulësesh.

Kjo lëvizje thuhet se është bërë për ta sfiduar Erdoganin. "Miqqtë tanë nuk do të njihen si deputetë që lëshuan partinë e tyre. Historia do t'i njohë ata si heronj që shpëtuan demokracinë", ka thënë zëdhënësi i partisë CHP, Bulet Tescan.

Protesta kundër kryeministrit armenian

JEREVAN, 22 PRILL - Në Armeni vazhdojnë për të dytën javë protestat kundër ndryshimeve kushtetuese dhe vënies në detyrë si kryeministër Serzh Sargsyan. Kritikët thonë se me ndryshimet e fundit të Kushtetutës armene, Sargsyan, i cili më parë ka

mbajtur postin e presidentit për dy mandate pesëvjeçare, praktikisht do të bëhet udhëheqës i përgjithshëm i vendit.

Policia speciale e Armenisë u përlesh me protestuesit dhe përdori gaz lotsjellës për të shpërndarë një tubim masiv sot në krye-

qytetin Jerevan.

Shtatëdhjetë njerëz u arrestuan, duke përfshirë dhe udhëheqësin e protestës dhe ligvënësin opozitar Nikol Pashinian.

Po të dielën, gjatë bisedimeve të transmetuara nga televizioni, kryeministri Serzh Sargsyan doli

nga bisedimet me Pashinian, pasi udhëheqësi i protestës këmbënguli për dorëheqjen e kryeministrit. Sargsyan tha se kërkesa ishte shantazh. Protestat masive kundër qeverisë së re tani kanë hyrë në javën e tyre të dytë në kryeqytet.



Gjermania tashmë një vend tipik multikulturor



Nga Mimoza KELMENDI

Sipas statistikave zyrtare, numri i të huajve (jo nga vendet e BE-së) përbën rreth 4.2 % të popullsisë së Bashkimit Evropian që numëron një gjysmë miliard. Por flukset e viteve të fundit me emigrantë kanë bërë që ata të përqendrohen më së shumti në disa vende të BE-së. Atje bëhet faktori multikulturor edhe më i fuqishëm se diku tjetër.

Sipas të dhënave zyrtare, Gjermania është destinacioni kryesor për emigrantët në Evropë. Si kurrë më parë, në Gjermani jetojnë tani kaq shumë njerëz me prejardhje të huaj. Sipas Zyrës Federale të

Statistikave, në vitin 2017 ishin regjistruar 10,6 milionë persona me pasaporta të huaja. Prej vitit 2009 numri i të huajve në Gjermani ka ardhur duke u shumëfishuar. Një nga arsyt kryesore të rritjes së numrit të të huajve është edhe të ardhurit nga vendet anëtare të reja në BE si: Rumania, Polonia, Bullgaria. Shumë evropianë tashmë po i braktisin vendet e tyre të lindjes. Vendin e parë e zënë turqit, pastaj vijne polakët, sirianët, italianët, rumunët, kroatët, grekët, bullgarët. Vetëm në vitin 2017 janë regjistruar 538 mijë të huaj (refugjatë) që kanë kërkuar mbrojtje në vendet e BE-së, 60 % e të cilëve në Gjermani.

Të gjithë jemi dëshmitarë që qytetarë nga Evropa Lindore pas viteve të '90-ta u larguan për të jetuar në vendet e BE-së. Edhe pas viteve 2012-2017 pati një fluks të madh refugjatësh nga vendet arabe dhe Ballkani. Kështu shtetet kombëtare të Evropës Perëndimore, duan

apo s'duan, janë bërë e po bëhen gjithnjë e më multikulturore, që nuk mund të integrojnë e aq më pak të asimilojnë atë çka vërshon drejt tyre. Po qe se kjo është e vërtetë, atëherë këto shtete duhet ta përballojnë në një mënyrë të ndershme dhe me dinjitet njerëzor. Duhet të kujdesen që konfliktet të sheshohen, diskriminimi të pengohet dhe që format e ndryshme të jetës ta respektojnë njëra-tjetrën. Pra, nuk bëhet fjalë vetëm për raportin e vendësve me të huajt, por edhe për konfliktet e të huajve mes njëri-tjetrit. Dhe brenda këtyre grupeve të popullsisë ka minoranca të vogla agresive, që e kanë në dorë nëse mbizotëron paqe apo plasin bomba.

Qëkurse ekziston një kulturë evropiane, sjellja ndaj të huajve vlen si kriter etik. Vetë "Dhiata e Vjetër" mëson se i huaji duhet respektuar, i duhet ardhur në ndihmë, duhet pranuar dhe i duhet bërë vend. Por ajo, natyrisht, nënkupton se ekzistojnë

vendës dhe të huaj, pra njerëz që janë në shtëpi, në qytetin apo fshatin e tyre dhe të huaj që, ndoshta, të dëbuar ose në kërkim të një jete më të mirë dhe një atdheu të ri, trokasin në derën e vendësve. Në rast se qëndrojnë, gjejnë strehë dhe punë, atëherë fëmijët e tyre janë më pak të huaj, madje do të ndihen si vendës. Kjo ka ndodhur shpesh edhe në historinë e popullit gjerman. Para njëqind vjetësh erdhën në zonën e Ruhrit turma minatorësh polakë dhe, djemtë e tyre: Shepan, Urban, Kucora ose Tibulksi u treguan bashkëkombësve të tyre të rinj se si luhet futboll në ndeshjet e "Shalke 04". Të huajt u kthyen në vendës.

Shoqëria multikulturore nënkupton diçka tjetër: që të huajt mbeten në vazhdimësi të kufizuar, ngulin këmbë në gjuhën, zakonet dhe vlerësimet e tyre, dhe i përdorin ato përherë e, në rast nevojë, kundër vendësve ose emi-

grantëve të tjerë. Shoqëria multikulturore, po t'i shkosh në thelb, nuk njih vendës dhe të huaj, nuk njih kulturë që vendos kritere për jetën e përbashkët. Një demokraci e pjekur siç është ajo në Gjermani mund të durojë mjaft larmi kulturore dhe gjuhësore, por jo ama kultura të veçanta, të ndara prej njëra-tjetrës, madje të pozicionuara kundër njëra-tjetrës.

Politika demokratike ka nevojë për qytetarë të përgjegjshëm, pra edhe emigrantë, të cilët janë në gjendje të përfytyrojnë se ata dhe fëmijët e tyre do të bëhen qytetarë të tillë. Te këta qytetarë të Gjermanisë bëjnë pjesë edhe ata njerëz që kanë lindur në Kurdistan apo Afrikën Perëndimore, në Siri apo Irak, në Kosovë apo Marok nga një kulturë tjetër, me një tjetër ngjyrë ose tjetër fe nga ajo e pjesës më të madhe të vendësve.

Dhe ata duhet ta dëshirojnë një gjë të tillë.

Këndvështrim për romanin 'Psycho' të Ilir Muharremi



Shkruan: Faruk BUZHALA

Ilir Muharremi me romanin "Psycho" ka arritur të krijojë një personazh mjaft kontrovers dhe të frikshëm. Guximi i tij që t'i qaset një karakteri të tillë të komplikuar, e bën lexuesin të hamendet dhe ta njohë më mirë botën me të cilën rrethohet dhe në të cilën frymon. Mendja e njeriut është një laborator ku njeriu eksperimenton me veten dhe me të tjerët. E shkrimtarët janë ata që më së miri transformohen në lloj-lloj karakteresh dhe krijojnë personazhe mjaft të ndërlikuar, interesantë dhe perversë! Është Oscar Wilde me Dorian Grejin, është Dostojevski me Raskolnikovin, është Suskindi që krijoi Grenujinin etj. Po ashtu, janë edhe regjisorët ata që u morën me këtë tematikë. Ndër ta më i famshmi ishte dhe është Hiçkoku me filmin e tij të njohur "Psycho", Martin Scorsese me filmin e tij "Taksisti" ku rolin kryesor e luan Robert de Niro etj. Pra, karakteri me të cilin merret

Ilir Muharremi në këtë roman është subjekt edhe i shumë artistëve të tjerë që janë munduar ta paraqesin sa më mirë këtë zonë të errët të psikikës së njerëzve që njihen si vrasës serikë apo "Psycho". Autori i këtij romani e ka krijuar në mënyrën e vet një personazh pa emër që e identifikon me një njeri të dështuar në jetë dhe që ka ndërlikime psikike dhe i cili rrëfëhet duke i shpalosur para dëgjuesit (që në këtë rast është banakierja, personazhi tjetër statik i këtij romani) të gjitha mendimet e errëta të egos së tij. Është ky një zemërim, që i vjen kohë pas kohe, me plot emocione abstrakte dhe të çregullta.

Po të analizohet më mirë qasja që i bën autori personazhit të tij, mund të shohim dhe kuptojmë botëkuptimet e tij për shumë tema dhe çështje të rëndësishme sociale dhe jetësore. Pezmi i tij shpërfaqet në dimensione konkrete që kanë të bëjnë me tema të caktuara siç janë: vetmia, morali, degjenerimi, seksi, krimi, dhe marrëdhënie të tjera të ndërlikuara personale dhe shoqërore. I tërë subjekti që shtjellohet në këtë

roman është një monolog që rrëfëhet në vetën e parë dhe le të kuptohet se personazhi pa emër, tërë kohën është nën ndikim të alkoolit! Sentencat filozofike që dalin nga goja e personazhit janë mjaft të sendërtuara dhe paraqesin botëkuptimin e tij rreth çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me aktualitetin. Mllef i tij shkon aq larg dhe prek deri te ekstremiteti më absurd që njihet me emrin antropofagjia.

Ka shumë supozime dhe studime që flasin për këtë akt që nga antika e deri në kohën e tashme. Vërehet se autori ka shfletuar literaturë dhe ka gjetur burime informacionesh të bollshme rreth kësaj teme, të cilat i paraqet në këtë libër duke e bërë sa më të plotë figurën dhe karakterin e personazhit të tij. Në këtë rast më duhet ta parafrazoj një dukuri që e paraqet Orwelli në romanin e tij të njohur 1984 ku në programin e dy minutave të urrëjtjes, Uinstoni në një moment e zhvendos shikimin plot urrëjtje nga fytyra në tele-ekran tek vajza flokëzeze mbra pa tij dhe për një çast i shkrepit në mendje halucinacione të gjalla e të bukura. "Do ta rrihte për vdekje me një shkop gome. Do ta lidhte pas një huri dhe do ta qëllonte me shigjeta si Shën Sebastianin. E mandej do ta përdhunonte dhe do t'i priste gurmazin në çastin e orgazmës. Dhe e kuptoi pse e urrente më qartë se më parë. Sepse ajo ishte e re, e bukur dhe pa feminitet, sepse ky donte të shkonte në shtrat me te dhe nuk do t'ia arrinte kurrë, sepse rreth belit të saj të hollë dhe të bukur, i cili

fronte të përfshihej në krahë, gjendej vetëm brezi i kuq dhe i neveritshëm, e që ishte simboli i dëlirësisë".

Kjo dukuri që e paraqet Orwelli në romanin e tij, vije si pasojë e urrëjtjes që shfaqet te personazhi kryesor i veprës së tij e që na bën të kuptojmë se secilit nga ne në çaste tendosjeje dhe nervoze, na vinë në mendje ide perverse dhe të çmendura që na bëjnë të shprehemi duke thënë fjalë banale që na dalin pavetëdijshëm nga goja. Në këtë rast, unë nuk po bëj krahasime në mes të Ilir Muharremi dhe George Oewellit si shkrimtarë që përshkruajnë të njëjtin problem nga këndvështrime të ndryshme, por vetëm desha që ta vërtetoj atë që e thashë (shkrova) më lartë. Pra, edhe romani "Psycho" na e jep të njëjtnë ndjenjë dhe na bën të kuptojmë se në mesin tonë mund të ketë njerëz të tillë që janë plot urrëjtje ndaj nesh dhe të tjerëve. Autori në këtë libër është munduar ta portretizojë një mostër të tillë në mënyrën e vet, dhe sa ia ka arritur, ju mbetet juve që ta shihni dhe analizoni gjatë kohës sa e lexoni këtë roman i cili është romani i parë tek ne që e rrahë këtë temë, e që ka të bëjë me njerëz me çregullime të mëdha mendore dhe që flet për kanibalizmin si një dukuri aktuale dhe të dukshme.



Telefonat inteligjentë në ndihmë të pacientëve të shëndetit mendor

Reth 1% e popullsisë së botës ka sëmundjen mendore të quajtur çrregullimi bipolar, që karakterizohet nga zhvendosja ndërmjet një gjendjeje të mirë shpirtërore dhe depresionit. Në shumicën e rasteve, ndërhyrja në kohën e duhur nga psikoterapistët, familjarët dhe miqtë mund t'i lehtësojë simptomat. Shkencëtarët në Danimarkë thonë se teknologjia moderne mund të ndihmojë duke gjurmuar simptomat e pacientit dhe duke lajmëruar për ndihmë në kohën e duhur. Shfaqjet e çrregullimit bipolar variojnë nga më të lehtëta dhe deri tek më të rëndat. Pacientët mund të përjetojnë periudha ekzaltimi dhe depresioni, secila prej tyre me simptomat e saj. Gjatë periudhave energjike, pacientët janë jashtëzakonisht aktivë, flenë më pak gjumë dhe ndonjëherë marrin vendime të rrezikshme. Ndërsa gjendja depresive i bën të qajnë, të qëndrojnë tepër gjatë në krevat, dhe ndonjëherë të mendojnë për vetëvrasjen.

Në ato momente, pacientët kanë nevojë që dikush t'u telefonojë. "Kur je në depresion është e vështirë t'u thuash njerëzve se do ndihmë", thotë Peter Hegeland, pacient bipolar. Kompania daneze Monsenso krijoi një aplikacion celulari që mund të analizojë gjendjen shpirtërore dhe sjelljen, si dhe mund të lajmërojë terapistët dhe anëtarët e familjes. Mads Trier-Blom, një nga pacientët bipolarë që po teston aplikacionin, thotë se ndërsa ndjehej i tensionuar, një terapist që monitoronte gjendjen nga larg, telefoni menjëherë për t'u interesuar. "Parametrat matëse i merr doktorja, e cila më telefonon nëse shikon diçka shqetësuese", thotë zoti Blom. Krahas regjistrimit të sjelljes së pacientit dhe ndërveprimit me të tjerët, aplikacioni kërkon edhe vetëvlerësimin e pacientit. Të gjitha të dhënat krahasohen me dosjen e pacientit në klinikë. Psikiatri suedez Kristoffer Sodersten po e përdor aplikacionin



me pacientët e tij. "Këto lloj të dhënash, të kombinuara me vetëvlerësimin, mund të tregojnë nëse ka përputhje apo

jo", thotë zoti Sodersten. Pacientët bipolarë që testuan aplikacionin thonë se regjistrimi i hershëm i ndryshimeve në

gjendjen e tyre shpirtërore, po i ndihmon të mësojnë si të përballen me simptomat kur ato shfaqen. (gazeta-Shqip.com)/VOA

Kur Madonna punonte kameriere

Ajo ishte një kameriere e tmerrshme nuk puna në këtë profesion nuk i zgjati shumë. E kush mund ta mendojë se ylli i muzikës botërore e ka nisur karrierën nga gjërat e thjeshta. Është e vështirë të imagjinohet tani, që ylli i muzikës njëherë e një kohë u pushua nga puna te Dunkin' Donuts, një kompani e njohur që bën petulla amerikane dhe ka një grup kafenes. Në atë kohë, këngëtarja kishte lënë kolegjin dhe ishte zhvendosur në Nju Jork, në kërkim të famës. Por kohët ishin të ashpra, ndaj ajo pranoi një punë të thjeshtë për të bërë disa para. Ajo u pushua pasi aksidentalisht derdhi xhelatinë petullash mbi një klient. Jeta e saj nuk ka qënë aspak e thjeshtë të paktën fillimet, ndaj Madonna ka refuzuar dhe idenë e hedhur për një film biografik për fillimet e karrierës së saj. Rruga e famës për Madonën nisi në 1978 në

Nju Jork, kur ajo takoi fotografën Michael McDonnell. 20-vjeçarja e veshur e gjitha në të zeza me xhinse të grisura dhe flokët me onde, kishte tërhequr vëmendjen e fotografit. Ai i kërkoi Madonës që të pozonte për atë dhe këngëtarja e pranoi kërkesën. Më pas ata kanë punuar bashkë për 8 muaj. McDonnell nuk zbuloi tek ajo vetëm pamjen e jashtme por edhe karakterin e yllit të muzikës që së shpejti do të bëhej e famshme. Por përtej këtyre detajeve duket se fëmijëria dhe fillimet e karrierës nuk kanë lënë gjurmë të bukura në memorien e këngëtares, e cila refuzon herë pas here idetë e hedhura për të bërë një film apo një libër mbi jetën e saj. Duket se Madonna do ta shohë të shkuarën thjesht si të shkuar, dhe të jetojë ashtu siç jeton me shumë pasion të tashmen. (gazeta-Shqip.com)

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Furra Trepça", SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: Nrb. biznesit 810019936 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Furra Trepça" d.o.o. od Fushë Kosova, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: Nrb. biznesit: 810019936, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Furra Trepça", L.L.C. in Fushë Kosova, has come to the decision to quit its business: Nrb. Biznesit: 810019936, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Reperi i njohur bëhet baba për herë të dytë



Reperi Benjamin Hammond Haggerty, i njohur me emrin e artistit Macklemore dhe bashkëshortja e tij Tricia Davis, kanë mirëpritur fëmijën e tyre të dytë së bashku. Reperi 34-vjeçar ka njoftuar se Tricia solli në jetë një vajzë e cila lindi një muaj më parë.

Macklemore ka bërë me dije këtë lajm pasi u pyet se si i kaloi pushimet. "I kalova në spital. Me vajzën time e cila erdhi në jetë", ka thënë për "Spin 1038". Macklemore dhe Tricia janë prindër edhe të një vajze dyvjeçare.

Courtney grindet me të dashurin në aeroport



Aktorja Courtney Cox dhe i dashuri i saj Johnny McDaid ishin ribashkuar në vitin 2016 dhe që nga atëherë kanë qenë gjithmonë e më të afërt, shkruan "Daily Mail". Megjithatë, ylli i

serisë hit "Friends" u pa duke u grindur me Coxin kur aterruan në aeroportin e Los Angelesit. Mësohet se 53-vjeçarja dhe 41-vjeçari po ktheheshin nga një udhëtim nga Nju Jorku.



Djali i Angelina Joliet po bëhet pilot

Angelina Jolie ka një talent të njëjtë me djalin e vet nëntëvjeçar. Aktorja 42-vjeçare mori licencën për pilote në vitin 2014 dhe tani zbuloi se Knox është duke shkuar rrugës së saj, për t'u bërë pilot. "Dua të jem në ajër. E dua lirinë", ka pohuar Angelina



gjatë dokumentarit të fundit "The Queen's Green Planet". Ajo ka bërë me dije se djali i saj, Knoxi, po mëson të drejtojë një avion. "Më bën të lumtur ta shoh atë. Ai ende ka nevojë për ndihmë me pedalet, por nuk do të zgjasë shumë", ka thënë Angelina.

Ndërron jetë aktori i vogël



Verne Troyer, i njohur më së shumti për rolin e luajtur "Mini-Me" në filmat e "Austin Powers", ka ndërruar jetë në moshën 49-vjeçare. Troyer, i cili ishte 81 cm i gjatë, ka luajtur gjithashtu në filmin e parë të "Garry

Potter". Troyer u shfaq në një numër spektaklesh televizive, duke përfshirë Celebrity Big Brother në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2009. Ai ka bërë edhe paraqitje të rregullta në Celebrity Juice dhe ka luajtur në disa filma.

Autor : GAZMEND MORINA	KËNGËTARI KANADEZ NË FOTO 1	TMERR	▼	MOSHË E RE PËRÇARJE	LIBËR PERSONAL PËR MBAJTJEN E SHËNIEVE DITORE	AUTORITET, NDER QË KA DIKUSH (turq.)	MOLDAVIA, URUGUAI	EPOKA ERE	BASHKËTING- ËLLORE	DIJETAR FETAR MYSLIMAN	LLOJ HELMI LUFTE (shq.)	PËREMËR PRONOR																				
VESHJE E NJË MAKINE LUFTARAKE ME MBUROJË ÇELIKU	○							BUNARI I UJIT RRJETEZA E SYRIT (sh.shq.)																								
RADHITUR	○								ISLAM (perkdh.) TITANIUM																							
PORTIERI ITALIAN KRISTIAN (MILAN)	○						AJRI I PASTËR MBI RETË (libr.) FJALË TING- ULLIMITUESE																									
"JEMENI"	○		SABOTAZHI																				DICKA E MËRZITSHME DHE E PADËSHIRUE- SHME, NGAQË PËRSËRITET GJITHNJË									
AGIM TEJECI	○		PERSIA E SOTME SHTET NË AFRIKË						AKTORJA ANGLEZE ... FRIEL SHKRETËTIRA MË E THATË NË BOTË																							
FILLOJ	○			FORMË QEVERISJE	KËNGËTARJA NISHLIU ANDORA					KATËR (romak) EMRI I PASHAIT I JANINËS																						
ZANORE	○	AKTORJA HOLLIVUDIANE ... TURMAN I KURORËZUAR				SPIUNIA E NJOHUR HARI "KENIA"					ZANORE SHUMË I LODHUR, I KËPUTUR, I LIGËSHTUAR	NËNË (turq.)						PUNË E PAHIJSHME DHE E PANDERSHME QË TË NGJALL PËRBUZJE	"OSASUNA"	DIKASTERI	PARA TË NËNTIT											
KËNGËTARE E NJOHUR ANGLEZE (origj.)	○				NXITËSI I NJË VEPRIMTARIE QYTET I MADH NË GJERMANI (shq.)																											
PJESËTARET E NJË FISI ILIR	○							AKTORJA E NJOHUR BASINGER KRONIZA										FEMRAT E SAPOMART- UARA NËNA, ËMA (shq.)														
QENGJ I BUTË, QË ËSHTË MËSUAR TË NDJEKË PAS BARIUN	○					NJËSI KOHE			BASKETBOLL- ISTI TURK ONAN ENI LENOKS								SELEN DJALLËZOR															
SIRIA, RUANDA	○		RENS ISTVUD EVERTON			AKTORJA AMERIKANE ANDERSON							AQ SA NXË, DERI NË BUZË KAMPIONI, ASI (Sport)																			
EPOKA ERE	ARMË GJAHU ME NJË TYTË DHE ME FISHEKË SI TË CIFTES UÇK (ang. origj)					SMALTIMI I SISTEMATIZU- AR												DUKATI UGANDA														
NË ÇFARË VENDI			KUNDREJT I VJETËR KASTRIOT TUSHA				ILLINOIS QENIE JASHTËTOK- ËSORE (shq.)		LLOJ QELQI QË PËRDORET PËR TË BËRË SENDE ZBUKURIMI	LËNDË QË PËRDORET PËR TË LARË TRUPIN (shq.) RENNES								SHKENCA MBI MORALIN														
GRACKË, KURTH			HEROI BOLETINI ZANORE					QYTET NË SHQIPËRI INDUCTION LINGUISTIC KNOWLEDGE										EMPOLI I MITUR, AXHAMIU	ZANORE PJATA													
KËNGËTARJA BAJRAMI						AKTORI PRAPASHTICA				GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.) KARBON, TON																						
													ELEMENT KIMIK										DASHUROR	TALLJE QË BËHET NË MËNYRË TË HOLLË E TË MBULUAR "TORINO"								
													FJALI E NJË VEPRE A E NJË DOKUMENTI (sh.shq.)												SHTET I MADH NË AZI HAKIK (perkdh.)							
													"ENDOKIA"						TOKIO MUZIKANTI KRASNIIQI			ZHANËR I MUZIKËS (shq.) EMËR MASHKULLI ANGLEZ					PATRIOTI RRUSTEMI	ANCONA MANEKINIA & AKTORJA AMERIKANE VON TEESE				
													XEHETARI														ADEM DEMAÇI DY ZANORE				DJALI I DJALIT A I VAJZËS (pashq.)	
													ZANORE					VEGËL NOTË MUZIKORE							KËNGËTARI NË FOTO 2 RICHARDSON (BACKSTREET BOYS) "KIOTA"	○	○	○	○	○		
													PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE (Nofka)								KLUB FUTBOLLI NGA KRYEQYTETI SUEDEZ ZANORE						KUNDËR OHIO					
													MJET TRANSPORTI PA MOTOR, QË TËRHIQËT NGA NJË AUTOMJET																		INDUSTRIAL ALLIANCE PACIFIC	

ZGJIDHA E FJALËKRYQIT: BLINDIMI, PUSI, RENDITUR, LAM, ABIATI, ETERRI, JE, SABOTIMI, AT, IRANI, ANA, NIS, RONIA, IV, A, UMA, MATA, A, DIDO, KATALIZATORI, AMANTET, KIM, NUSËT, MANAR, ORA, OMER, SE, SR, RI, PAMELA, PLOT, TEKE, EMALIMI, ARI, KU, I RI, I, SAPUNI, LAK, ISA, KRUA, E, ARTA, ILIR, RARITET, SILIC, IRONI, TEKSTET, IRAK, EN, T, ROKU, A, MINATORI, AD, U, ALET, KEVIN, AMI, AIK, ANTI, RIMORKIO, IAP.

E jashtëzakonshme

15 milionë dollarë për të fjetur me peshqit

Mysafirët në Conrad Maldives Rangali Island së shpejti do ta kenë mundësinë të flenë me peshqit, pasi po ndërtohet vila nga xhami nën ujë. Imazhet tregojnë se potencialisht do të jetë një nga dhomat më të preferuara të hoteleve në botë. Hoteli është rreth 5 metra nën valë. Ka një



dhomë gjumi, një dhomë ndjenje dhe një banjë. Apartamenti, i quajtur Muraka, ka kushtuar 15 milionë dollarë për t'u ndërtuar.

FOTO E DITES



Një kamion që transportonte 20 ton peshq e humbi ngarkesën e tij pas rrëzimit në një rrugë pranë Liepenit në Gjermaninë Lindore. /AFP/

E rrallë

Ndëshkoi 10-vjeçarin duke e qethur, dënohet me burgim berberi

Një berber i cili qethi qëllimisht një fëmijë 10 vjeç, në mënyrë që të tjerët të qeshnin me të, është dënuar me tetë muaj burgim. Ngjarja ka ndodhur në Angli ku berberi 21-vjeçar ia preu fëmijës flokët si dënim, sepse ai kishte luajtur me sendet e punës së tij, shkruan "Daily Mail".



Djaloshi dhjetëvjeçar thirri policinë, pastaj berberi u arrestua.

BARSOLETA E DITËS



Burri: Nëse të tradhtoj, çfarë bën?
Gruaja: Të sjell lule.
Burri: Pse lule?
Gruaja: Se te varri nuk vihet pa lule.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

“BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
 Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
 Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
 Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

“RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
 Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, **fb: Kino ABC.**



DASHI

Ata që po kërkojnë nga ju gjëra të


caktuara nuk po ju specifikojnë se çfarë duan. Kjo paqartësi do të krijojë probleme në komunikim.



DEMI

Nëse sot nuk dëshironi të bëni më

tepër seç ju kërkohet, keni gjithë komoditetin për të mos vepruar. Dita do të shkojë qetë dhe pa ndonjë zhvillim.



BINJAKËT

Do të kërkonti të pushoni sot nga

ngarkesa e javës. Keni menduar një fundjavë të këndshme dhe larg zhurmave të qytetit.



GAFORRJA

Keni lënë shumë pas dore aspektin

tuaj social, por tani është pikërisht koha për t'u marrë sa më shumë me ngjarje dhe veprimtari sociale.



LUANI

Sot po prisni t'ju nxjerrin jashtë nga

plogështia që ju ka kapluar. Një ftesë nga miqtë do të vijë pikërisht në momentin e duhur.



IRGJËRESHA

Mënyra më e mirë për të qenë afër

dikujt është t'i qëndroni pranë fizikisht, edhe pse mund të mos flisni. Do të ndjeni mirënjohje karshi jush.



PESHORJA

Keni kuptuar që me kalimin e kohës

ndryshojnë gjërat dhe njerëzit. Thjesht do t'ju duhet të përshtateni me risitë që sjell dita.



AKREPI

Nëse doni që persona të caktuar të tolerojnë

lidhur me çështje të përbashkëta edhe ju reciprokisht duhet të bëni të njëjtën gjë.



SHIGJETARI

Keni dyshime mbi një person të

caktuar dhe po prisni që nga momenti në moment të bëjë një hap fals për t'i vërtetuar dyshimet tuaja.



BRICJAPI

Mos kini frikë për çfarë ju sjell e

ardhmja sepse në çdo rast ju i keni marrë masat të mos gjendeni keq nga ana financiare.



UJORI

Gjithçka rreth e qark jush ju shtyn të

merrni sa më shpejt një vendim. Por ju jeni tip që i besoni shumë kohës dhe vendimeve të matura.



PESHQIT

Provoni të bëni disa hapa pas nëse

shikoni që një hap para nuk ju ka funksionuar. Do të mund ta përmirësoni situatën tuaj karshi eporëve.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ATHLETIC BILBAO - LEVANTE

GG

HOLSTEIN KIEL - NURNBERG

GG

GENOA - HELLAS VERONA

1

'Elita' mbledh medaljet në gjimnastikë

Klubi i "Elitës" nga Prishtina ka dominuar në garën e mbajtur në shkollën "Mihal Grameno" në Fushë-Kosovë, duke rrëmbyer 19 medalje. Ky sukses nuk e ka habitur shumë trajnerin Abelianna Bregu, e cila synon të bëjë "bum" në arenën ndërkom-bëtare. "Synojmë një aktivitet jashtë vendit, por ende nuk është konfirmuar. Për këtu në Kosovë synojmë të jemi më të mirët. Klubi i Elitës shumë shpejt do të jetë i pakonkurrencë, pasi niveli është i lartë dhe synojmë të përballemi me botën e jashtme", ka thënë Bregu

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 22 PRILL - Klubi i Gjimnastikës "Elita" nga Prishtina ka shkëlqyer në garën e organizuar të shtunën nga Federata e Gjimnastikës së Kosovës (FGJK) dhe KGJ "Fushë Kosova", duke rrëmbyer 19 medalje. Në këtë garë pjesëmarrës ishin shtatë klube, kurse kanë shkëlqyer motrat gjimnaste, Lisa dhe Vilëza Zeqiri, që janë pjesë e klubit nga kryeqyteti "Elita". Lisa ka zënë vendin e parë në disiplinat Parter në Traun e Ekuilibrit si dhe vendin e tretë në disiplinën Kapërcime, kurse motra e saj më e vogël, që shihet edhe si e ardhmja e gjimnastikës së kryeqytetit, triumfoi në disiplinën Trau i Ekuilibrit. "Ishte një paraqitje e mirë e jona, dhe e treguar edhe një herë punën e madhe që po bëjmë në Klubin e 'Elitës'. Edhe në garat e tjera presim të fitojmë medalje", ka thënë Lisa Zeqiri. Pas rrëmbimit të 19 medaljeve, trajnerja e Klubit "Elita", Abelianna Bregu, ka thënë për "Epokën e re" se nuk është aspak e befashuar me performancën e nxënësve të veta. Garën e së shtunës dhe atë paraprake në muajin shkurt, Bregu i ka vlerësuar si më të mirat nga Klubi i "Elitës". "Do ta kisha veçuar performancën e disa vajzave që treguan nivel të lartë për nivelin e gjimnastikës që është në Kosovë. Ka qenë e dallueshme në krahasim me klubet e tjera. Paraqitja e vajzave ishte shumë e



mirë. Kjo garë, së bashku me atë të shkurtit, janë dy garat më të mira që kemi bërë deri tash, edhe numri i medaljeve është ndër më të lartat", ka thënë Bregu, e cila pati një notë kritike për organizimin e garës nga KGJ "Fushë-Kosova" dhe Federata e Gjimnastikës. "Gara lë për të dëshiruar. Ishte një organizim i mirë, por mund të ishte edhe më mirë, pasi zgjati gjashtë orë dhe kjo kohë është e mundimshme për sportistët dhe trajnerët. Ka ndikuar edhe në përqendrimin e fëmijëve për të pritur në radhë dhe për t'u futur në disiplinat e tjera gjimnastikore. Kjo ndikoi që në disiplinën e traut shumë fëmijë të dëshojnë për shkak të lodhjes dhe qëndrimit të gjatë në një ambient të mbyllur", ka shtuar Bregu. Trajnerja nga Shqipëria ka paralajmëruar se klubi në të cilën punon shumë shpejt do të jetë i pakonkurrencë në Kosovë, por

synim kryesor e ka pjesëmarrjen në garat e arenës ndërkom-bëtare. "Synojmë një aktivitet jashtë vendit, por ende nuk është konfirmuar. Për këtu në Kosovë synojmë të jemi më të mirët. Klubi i Elitës shumë shpejt këtu do të jetë i pakonkurrencë pasi niveli është i lartë dhe synojmë të përballemi me botën e jashtme", përfundoi Bregu. Për garën e mbajtur të shtunën foli edhe trajnerja e Fushë-Kosovës, Sherife Aliçkaj-Qerimi. Ajo ka thënë se është e kënaqur me paraqitjen e garuesve dhe me mbarëvajtjen e garës. "Jam shumë e kënaqur me ecurinë e garës, por edhe me paraqitjen e garuesve tanë. Falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë, në veçanti Federatën e Gjimnastikës për mbarëvajtjen e kësaj gare. Presim që organizimi i garave në të ardhmen të jetë në nivel edhe më të lartë", ka deklaruar Aliçkaj-Qerimi.

Rezultatet e garës në Fushë-Kosovë

Disiplina Partner-Femra	(Vllka)	Disiplina Trau i Ekuilibrit	(Juniorë)
Bora Hoti	(Elita)	Lisa Zeqiri	(Elita)
Amela Gërbeshi	(Elita)	Eljesa Kaçiu	(Universiteti)
Jara Hasolli	(F. Kosova)	Erlisa Çerkini	(Elita)
Yvesa Islami (Ferizaj)			
Disiplina Partner-Femra (Pionere)		Disiplina Trau i Ekuilibrit (Seniore)	
Lonisa Reka	(Ferizaj)	Fitore Rudari	(Universiteti)
Valeza Rama	(Elita)	Doruntina Ibrahim	(Universiteti)
Ena Limani	(Elita)		
Disiplina Partner-Femra (Juniorë)		Disiplina Kapërcime Femra (Vllka)	
Lisa Zeqiri	(Elita)	Amela Gërbeshi	(Elita)
Malvesa Elezi	(Elita)	Vlera Gerguri	(F. Kosova)
Rizone Mustafa	(Elita)	Bora Hoti	(Elita)
		Una Mulla Ademi	(Omnisport)
Disiplina Partner-Femra (Seniore)		Disiplina Kapërcime Femra (Pionere)	
Dorentine Ibrahim	(Universiteti)	Valeza Rama	(Elita)
Fitore Rudari	(Universiteti)	Elena Mangjoll	(F. Kosova)
		Lonisa Reka	(Ferizaj)
Disiplina Partner-Meshkuj (Fatos)		Disiplina Kapërcime Femra (Juniorë)	
Erdirin Qerimi	(F. Kosova)	Eljesa Kaçiu	(Universiteti)
Vincenzo Del Re	(Omnisport)	Rizone Mustafa	(Elita)
Dite Behluli	(Omnisport)	Lisa Zeqiri	(Elita)
		Disiplina Kapërcime Femra (Seniore)	
Disiplina Partner-Meshkuj (Pioner)		Donika Kryemadhi	(Universiteti)
Taulant Ramadani	(Ferizaj)	Doruntina Ibrahim	(Universiteti)
		Fitore Rudari	(Universiteti)
Disiplina Partner-Meshkuj (Junior)		Disiplina Kapërcime Meshkuj (Fatos)	
Elion Viti	(Universiteti)	Dite Behluli	(Omnisport)
Elvis Çitaku	(Ardhmëria)	Vincenzo Del Re	(Omnisport)
Redon Qerimi	(F. Kosova)		
Disiplina Partner-Meshkuj (Senior)		Disiplina Kapërcime Meshkuj (Pioner)	
Mërgim Shala	(Ardhmëria)	Taulant Ramadani	(Ferizaj)
Endrit Hoti	(Trepça)		
Ardi Halili	(Ferizaj)		
Disiplina Trau i Ekuilibrit (Vllka)		Disiplina Kapërcime Meshkuj (Junior)	
Bora Hoti	(Elita)	Taulant Krasniqi	(Ferizaj)
Amela Gërbeshi	(Elita)	Redon Qerimi	(F. Kosova)
Elena Stefa	(Elita)	Elvis Çitaku	(Ardhmëria)
Disiplina Trau i Ekuilibrit (Pionere)		Disiplina Kapërcime Meshkuj (Senior)	
Vileza Zeqiri	(Elita)	Ardi Halili	(Ferizaj)
Valeza Rama	(Elita)	Endrit Hoti	(Trepça)
Lonisa Reka	(Ferizaj)	Mërgim Shala	(Ardhmëria)



Nadali triumfon për herë të 11-të në turneun e Montekarlos

Monte Carlo, 22 prill - Rafael Nadal fitoi turneun Masters të Montekarlos, duke mundur 2-0 në finale japonezin Kei Nishikori (6-3, 6-2 rezultati i dy seteve). Për tenistin spanjoll, numri 1 në botë,

ky është triumfi i 11-të në këtë turne, një rekord absolut, duke mbrojtur titullin e fituar vjet. Një paraqitje e shkëlqyer e Nadalit, që konfirmoi edhe një herë se në këtë sipërfaqe është i pathyeshëm.

Finalja ishte një dominim absolut i Nadalit, që pati epërsi në fushë në të dyja setet, duke u shkëputur që në pikët e para dhe thelluar diferencën. Nishikori, që rikthehej në fushë pas një pushimi të gjatë për

shkak të dëmtimit, bëri maksimumin e mundshëm, por ndaj Nadalit e pati të pamundur të rivalizojë dhe u dorëzua pa kushte. Për Nadalin ky është trofeu i 31-të në turnetë Masters, një rekord.



Arbnor Abazaj po shkëlqen në Gjermani

"Jam në pritje të një ftese, pasi dëshira ime është t'i mbrojë ngjyrat e Përfaqësueses së Kosovës", ka thënë Arbnor Abazaj

PRISHTINË, 22 PRILL - Futbollisti me prejardhje nga Mitrovica, Arbnor Abazaj, i cili ka lindur në Gjermani, është duke shkëlqyer në grupmoshat U16. Ai aktualisht mbron ngjyrat e Klubit VfL Wolfsburg II dhe këtij ekipi i është bashkuar para një viti. Abazaj më parë ka luaj-

tur edhe në ekipin Holstein Kiel U15 dhe ka qenë një ndër katër sulmuesit më të mirë në Gjermani për atë moshë. Abazaj ka shënuar gol të shtunën në përballje ndaj Lubeckut si mysafir ku ekipi i tij ka fituar me rezultat 1-0, pra goli i shqiptarit nga Kosova ka

qenë përcaktues në fituesin e ndeshjes. Edhe pse në moshën më të mirë, deri më tash askush nuk e ka kontaktuar Abazajn nga Përfaqësuesja e Kosovës. Futbollisti në fjalë të dielën, i kontaktuar nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", ka thënë se është nder dhe kre-

nari ta përfaqësojë Kosovën, por ende s'ka marrë asnjë ftesë dhe që me siguri në një të ardhme do të ketë fatin të ftohet në Përfaqësuesen e Kosovës. "Jam në pritje të një ftese, pasi dëshira ime është t'i mbrojë ngjyrat e Përfaqësueses së Kosovës", ka thënë Abazaj.

Rexha vendos derbin e tensionuar ndaj Llapit



PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Sulmuesi Kastriot Rexha ka qenë vendimtar në derbin Llapi - Drita, pasi ka shënuar tre golat për skuadrën gjilanasë në ndeshjen që përfundoi 1-3. I pari shënoi Llapi nëpërmjet Mirlind Dakut, por më pas Rexha shënoi tre golat që e ofrojnë edhe më shumë Dritën te titulli i kampioneve. Kjo ndeshje ishte mjaft e tensionuar dhe kishte edhe hyrje të tifozëve në fushën e lojës dhe ndërprerje të lojës për shumë minuta derisa u zbrazën tribunat ku ishin të vendosur

tifozët vendës. Fitore në këtë xhiro ka shënuar edhe Prishtina ndaj Vllaznisë së Pozharanit (0-1), kurse golin e vetëm e ka shënuar Mankenda në minutën e 33-të. Lufta për titull pritet të zhvillohet në mes të Dritës dhe Prishtinës, pasi skuadrat e tjera kanë mbetur një hap pas. Të dielën fitore ka shënuar edhe Drenica në Pejë ndaj Besës falë golit të shënuar nga Genc Hamiti. Flamurtari është ngritur në pozitën e barazhit, pasi të dielën në kryeqytet e mposhti Vllaznimin nga Gjakova (1-0).

VALA SUPERLIGA - JAVA E 28

Llapi - Drita	1-3
Vllaznia - Prishtina	0-1
Besa - Drenica	0-1
Flamurtari - Vllaznimi	1-0
Gjilani - Trepça '89	2-0
Feronikeli - Liria	0-0

TABELA

1. Drita	56 pikë
2. Prishtina	53
3. Llapi	45
4. Liria	44
5. Gjilani	43
6. Trepça '89	43
7. Feronikeli	42
8. Drenica	42
9. Vllaznimi	35
10. Flamurtari	18
11. Besa	18
12. Vllaznia	14

Në xhiron e radhës takohen: Trepça '89 - Flamurtari, Vllaznimi - Besa, Drenica - Vllaznia, Prishtina - Llapi, Drita - Feronikeli, Liria - Gjilani.

LIGA E PARË - JAVA E 26

Ballkani - Ferizaj	4-0
Kika - 2 Korriku	2-1
Bashkimi (K) - Rahoveci	2-2
Hajvalia - Dukagjini	2-1
KEK-u - Vushtrria	1-1
Fushë-Kosova - Vitia	3-2
Ramiz Sadiku - Trepça	0-1
Kosova (P) - Onix Banj	2-2

TABELA

1. Ballkani	57 pikë
2. KEK-u	56
3. Vushtrria	53
4. Ferizaj	47
5. Onix	41
6. Fushë-Kosova	41
7. Bashkimi (K)	33
8. Dukagjini	32
9. Vitia	32
10. Ramiz Sadiku	32
11. Trepça	32
12. 2 Korriku	30
13. Rahoveci	27
14. Kika	27
15. Hajvalia	26
16. Kosova (P)	8



Rocketsi pëson humbjen e parë në 'play-off'

MINNESOTA, 22 PRILL - Minnesota Timberwolves ka rihapur çështjen e kualifikimit me Houston Rockets, pasi ka fituar me rezultatin 121-105. Në 'Target Center' të Minneapolisit vendësit humbën me rezultatin 27-28 vetëm fraksionin e parë, ndërsa më pas interpretuan në mënyrë mjaft të mirë takimin, duke marrë edhe fitoren e parë dhe çuar rezultatin e përgjithshëm 2-1 për Rocketsin. Veçanërisht e mirë për vendësit ishte pjesa e tretë e lojës, të cilën e fituan me rezultatin 35-24, të udhëhequr nga dyshja Butler-Teague, që realizuan 51 pikë, 13 asistime dhe 10 rikuperime së bashku. Gjithsesi, pavarësisht prej humbjes, basketbollisti i Rocketsit, Hardeni, ishte lojtari më i mirë i ndeshjes, duke

shënuar 29 pikë, 7 asistime dhe 7 rikuperime. Në ndeshjen tjetër "play-off", atë mes Utah Jazzit dhe Oklahoma City Thunderit, ishte radha e vendësve që të fitonin me rezultatin 115-102 dhe ta marrin revanshin në rezultatin e përgjithshëm, 2-1. Miqtë e Oklahomës e nisën mjaft mirë sfidën, duke fituar me rezultatin 22-30 pjesën e parë, por u shturën totalisht në fraksionin e dytë dhe të tretë, të cilët i humbën konkretisht 36-23 dhe 31-22, duke bërë që diferenca të ishte praktikisht e pamundur për t'u përmbysur në pjesën e fundit të ndeshjes. Për Utah shkëlqeu spanjollli Rubio, që me 26 pikë, 10 asistime dhe 11 rikuperime, ishte në të njëjtën kohë edhe lojtari më i mirë i takimit.


MKRS-ja mbështet fuqishëm Donjeta Sadikun

PRISHTINË, 22 PRILL - Në kabinetin e Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me sportistën Donjeta Sadiku. Mbështetja financiare për sportistën Sadiku në vlerën prej 12 300 eurosh bëhet për shpenzimet e përgatitjes së sportistes

për Kampionatin Botëror në Nju Delhi-Indi. Ministri Gashi ka thënë se angazhimi i tij për t'i mbështetur sportistët nuk do të ndalet dhe se kjo bëhet me qëllim të përkrahjes së talenteve të rinj të cilët me punën e tyre të suksesshme po arrijnë ta përfaqësojnë Republikën e Kosovës në mënyrë

të denjë nëpër kampionate të ndryshme ndërkombëtare. Ndërkaq sportistja Donjeta Sadiku falënderoi ministrin Gashi për mbështetjen e tij, kurse premtoi se do të punojë maksimalisht që nga Kampionati Botëror në Nju Delhi-Indi të kthehet me medalje.





Drejtoria e administratës së përgjithshme dhe çështjeve kadrovike / Shërbimi për burime njerëzore dhe çështjet kadrovike

Duke u bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës L. NR. 03/L – 149 dhe në Rregulloren nr.02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, **Komuna e Graçanicës** shpall këtë:

KONKURS

KG103 - Zyra për Kthim dhe Komunitete

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Koordinimin e Kthimit të Qëndrueshëm

Numri i referencës: RN00003073

Niveli i pagesës: 407.55€

Qëllimi i vendit të punës

1. Zbatimi dhe promovimi së kthimit të qëndrueshëm

Detyrat Kryesore

1. Bashkëpunon me organet dhe organizatat e tjera në fushën e kthimit;
2. Bën hulumtime dhe analiza lidhur me promovimin dhe avancimin e të drejtave e të kthyerve;
3. Evidenton numrin dhe nevojat e të kthyerve, merr pjesë në punën e komisionit;
4. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjin dhe rregullat sipas urdhërit të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë;
5. Merr pjesë në hartimin e planit të punës dhe afateve për kryerjen e obligimeve të punës në fushën e kthimit;
6. Merr pjesë në hartimin e strategjisë komunale për kthim të qëndrueshëm;
7. Merr pjesë në krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrimin e të kthyerve.

Shkathhtësitë

1. Njohuri të mirë në kompjuter
2. Përparesi është njohja e gjuhëve që janë në përdorim zyrtar

Edukimi

1. Fakulteti i kryer në fushën e juridikut dhe administratës publike

Kualifikimi

1. Diploma universitare

Experienca


1. Përvojë pune së paku 2 vjet

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Opština Gracanica, ulica Cara Lazara bb. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me: Sandra Stevic Stankovic, në tel: 049-357-200 ose përmes postës elektronike sandra.stevic@rks-gov.net prej orës 8:00 -16:00. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në një nga gazetat ditore, përkatësisht nga data 23.04.2018. deri më 07.05.2018. Data 07.05.2018 konsiderohet data e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune, për të cilin konkurren. Kandidatët të cilën hyjnë në përzgjedhje të listës së ngushtë për intervistë do të informohen me telefon, në afat ligjor.

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.



Одељење за општу администрацију и кадровска питања / Служба за људске ресурсе и кадровска питања

На основу Закона Бр.03/Л-149 о цивилној служби Косова и Уредбе бр. 02/2011 за процедуре регрутирања цивилне службе Косова, **Општина Грачаница** објављује следећи:

KONKURS

KG103 - Канцеларија за повратак и заједнице

Титула радног места: Службеник за координирање трајних повратника

Бр. препоруке: RN00003073

Ниво плате: 407.55€

Сврха радног места

Спровођење и промовисање одрживог повратка

Главне Дужности

1. Врши контроле и анализе са циљем промовисања и унапређења права повратника;
2. Евидентира број и потребе повратника, учествује у раду комисија;
3. Учествује у стварању услова за одрживи повратак и интеграцију повратника;
4. Сарађује са другим органима и организацијама у области повратка;
5. Учествује у изради општинске стратегије за одрживи повратак;
6. Учествује у изради плана рада и рокова за извршавање радних обавеза у области повратка;
7. Обавља и друге послове у складу са законом и правилима по налогу непосредног руководиоца.

Врлине

1. Добро познавање рада на рачунару
2. Познавање језика у службеној употреби

Образовање

1. Завршен факултет у области права или јавне администрације

Квалификације

1. Универзитетска диплома

Искуство

1. Радно искуство најмање 2 године

Узимање и предаја пријава:

Општина Грачаница, улица Цара Лазара бб. За више информација можете ступити у контакт са: Сандра Стевић Станковић, на тел: 049-357-200 или путем e-mail sandra.stevic@rks-gov.net од 8:00 -16:00. Конкурс остаје отворен 15 дана од дана од објављивања у једним од дневних новина, односно од 23.04.2018. до 07.05.2018. Дан 07.05.2018. се сматра закључним даном конкурса.

Пријаве прослеђене поштом које носе жиг са задњим датумом за пријаву-сматраће се валидним и узимаће се у обзир за разматрање уколико стигну у року од 4 дана, пријаве које буду стигле након овог рока као и некомплетне пријаве неће се разматрати.

Пријави приложити копије документације о квалификацији, искуству и сву другу документацију тражену конкурсом за радно место за које се конкурише. Кандидати који уђу у ужи избор биће обавештени за интервју од стране персонала писмено или телефоном у законском року, и позвани кандидати треба да понесу оригинална документа ради провере пред комисијом за интервјуисање.

Цивилна служба Косова је на услузи свим грађанима Косова и радо очекује пријаве од жена и мушкараца из свих заједница на Косову.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149, Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Drejtor

Institucioni: Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve -IKMM

Kategoria funksionale : Koeficienti: 9.5

Numri i referencës: 19/2018

I përgjigjet: Drejtorit të Departamentit për Trashëgimi Kulturor

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Departamentit për Trashëgimi Kulturor, përbushë detyrat dhe përgjegjësitë e poshtëshënuara:

- Menaxhon punën e përgjithshme të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve - IKMM, cakton e objektivat dhe zhvillon planin e punës, për përbushjen e këtyre objektive;
- Menaxhon stafin e IKMM-se dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore;
- Bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/ përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Menaxhon ofrimin e produkteve dhe shërbimeve në fushën e trashëgimisë kulturore;
- Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me trashëgiminë kulturore dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;
- Ekzaminon dhe ofron komente rreth projektligjeve dhe akteve nënligjore dhe koordinohet me Departamentin Ligjor të MKRS-së, për dizajnimin e rregulloreve rreth trashëgimisë kulturore;
- Koordinon punën dhe bashkëpunon me drejtorët tjerë në institucioneve;
- Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre, në përputhje me standardet e kërkuara.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e Trashëgimisë Kulturore;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
- Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Diplomë universitare, në drejtimet: Arkitekturë, Histori, Arkeologji, Histori e Artit, Etnografi, Konservim, Restaurim dhe Menaxhim të Trashëgimisë Kulturore, Juridik, minimum 6 vite përvojë pune profesionale dhe 3 vite në vende udhëheqese.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjete (15) ditë.

Data e fundit e aplikimit është: 08.05.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni mund të shkarkohet nga Web faqja e MKRS-se dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereze" nr. 44. Për informata shpesh kontakti në numrin 038211 449 dhe 038 211 921 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona za Civilnu Službu Republike Kosova, Br. 03/L-149, Uredbe Br. 02/2010, o Procedurama Zapošljavanja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Direktor

Institucija: Institut za Zaštitu Monumentata Kosova-IZMK

Funkcionalna kategorija: Koeficijent 9.5

Referentni broj: 19/2018

Odgovara: Direktor Departmana za Kulturnu Baštinu

Lokacija: Priština

Dužnosti i odgovornosti: Pod nadzorom Direktora Departmana za Kulturnu Baštinu, obavlja dole navedene dužnosti i odgovornosti:

- Upravlja opštim radom Instituta za Zaštitu Monumentata Kosova-IZMK, određuje ciljeve i razvija radni plan, za ispunjenje ovih ciljeva;
- Menadžira osobljem IZMK-a, i organizuje rad putem podele dužnosti zaposlenima, pruža savete i nadgleda rad osoblja kako bi se pružili kvalitetni proizvodi i usluge;
- Vrši procenu procesa i unutrašnjih procedura i predlaže izmene/ ispravke sa ciljem povećanja efikasnosti i kvaliteta rada;
- Menadžira pružanje proizvoda i usluga u oblasti kulturnog nasleđa;
- Razvija i predlaže politike koje se odnose na kulturno nasleđe i nadzire sprovođenje istih;
- Proverava i pruža komentare u vezi nacrti zakona i podzakonskih akata i koordinise se pravnim odeljenjem MKOS-a na izradi uredba koje se odnose na kulturno nasleđe;
- Koordinise rad i saraduje sa ostalim direktorima institucija;
- Vrši redovnu procenu osoblja koje nadzire i podržava razvoj istih putem obuka za izvršenje njihovih dužnosti, u skladu sa traženim standardima.

Traženo obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične osobine:

- Poznavanje i suštinsko iskustvo iz oblasti kulturnog nasleđa;
- Sposobnosti dobre komunikacije, pregovaranja i uveravanja u menadžmentu;
- Sposobnosti za određivanje ciljeva, planiranja rada i analize;
- Sposobnosti u rukovođenju i organizovanju ekipe, sposobnosti menadžiranja ekipe ili radne grupe;
- Računarske sposobnosti u programskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);
- Univerzitetska diploma u: arhitekturi, istoriji, arheologiji, istoriji umetnosti, etnografiji, očuvanju, obnovi i menadžiranju kulturnim nasleđem, pravni fakultet i najmanje 6 godina stručnog radnog iskustva, i 3 godine iskustva u rukovođenju.

Procedura konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve kandidate.

Trajanje imenovanja: Imenovanje je na neodređeni rok.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren petnaest (15) dana.

Poslednji datum apliciranja je: 08.05.2018

Aplikacije koje se dostave putem pošte, sa poštanskom markicom, na poslednji dan konkursa, smatraju se važećim.

Podnošenje zahteva: Aplikacija se može preuzeti sa veb stranice MKOS-a i ista se dostavi u kancelariji 27 Ministarstva kulture, omladine i sporta, trg "Majke Tereze", br. 44. Za dodatne informacije molimo vas stupite u kontakt na 038211 449 i 038 211 921 (ili na veb stranici <http://www.mkrs-ks.org/>).



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, me datën 20. 04. 2018 shpall:

K O N K U R S

- Departamentin e Financave

1. Udhëheqës(e) i/e Divizionit të Kontabilitetit (1 vend pune)
2. Arkëtar/e (1 vend pune)
3. Zyrtar/e për mbledhje të të dhënave dhe raportimeve financiare (1 vend pune)

- Departamenti i Operativës

4. Inxhinier i mekanikes (1 vend pune)
5. IT për kamera dhe GPS (1 vend pune)
6. Auto-mekanik i autobusëve (1 vend pune)
7. Auto-çlektricitist i autobusëve (1 vend pune)
8. Auto-llamarist (auto-ngjyrosës) (1 vend pune)

Pozita 1: Udhëheqës/e e Divizionit të Kontabilitetit (1 (një) pozitë pune)

Kohëzgjatja e punës: 3 vite me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranon dokumentacionin financiar mbikëqyrë, koordinon dhe bën montimin.
- Kujdeset për saktësinë e kontimit, ndryshimet eventuale të paraqitura në planin – manualin kontabël.
- Përgatitë pasqyrat financiare mujore, tremujore dhe vjetore.
- Përpilon raporte të ndryshme për periudha të ndryshme.
- Përveç detyrave dhe përgjegjësi të cekura performon edhe në detyra tjera të kërkuara nga Mbikëqyrësi.

Kualifikimi dhe aftësitë :

- Diplomë Fakulteti Ekonomik, niveli Master drejtimi Financa dhe Kontabilitet (përparësi).
- Mbi 3 vite përvojë pune nga fusha e financave dhe kontabilitetit.
- Të ketë përvojë në programin softuerik "Bilanci" (të gjitha hapat nga krijimi i faturave blerëse, shitëse, dokument pagese deri në përpilimin e pasqyrave financiare - cikl i kontabilitetit), përparësi.
- Njohja e gjuhës angleze.
- Njohja e punës me kompjuter.
- Njohja e pakos Microsoft Office.

Pozita 2 : Arkëtar/e (1 (një) pozitë pune)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranon inkasimin e mjeteve (parave të gatshme) në baza ditore prej konduktoreve nga operimi ditor.
- Bën regjistrimin e pranimit të parave të gatshme në ditarin e arkës për secilin konduktor/e.
- Llogaritë gjithë mjetet e pranuar në përfundim – përmbledhje ditor.
- Pranon fletë-deponimin nga banka për mjetet e deponuara.
- Dorëzon në zyrën e financave ditarin e arkës me deponimet e të hollave nga konduktorët.
- Furnizon konduktorët/et me PEF dhe letër të arkës fiskale.
- Përveç detyrave dhe përgjegjësi të cekura performon edhe në detyra tjera të kërkuara nga Mbikëqyrësi.

Kualifikimet ;

- Diplomë në Fakultet Ekonomik/Biznesit bachelor.
- Mbi 2 vite përvojë pune në arkë.
- Përvojë një vjeçare në financa, përparësi.
- Njohja e punës me kompjuter.
- Njohja e paketës Microsoft Office.
- Njohja e gjuhës angleze përparësi.

Pozita 3 : Zyrtar/e të dhënave dhe raporteve financiare (1 (një) pozitë pune)

Kohëzgjatja e punës: 1 vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbledhë të dhëna nga operimi i punës në ndërmarrje.
- Pas mbledhjes së të dhënave bën përpunimin e tyre.
- Bën raportimin e të dhënave për konsulentin e BFRZI-it
- Duhet të jetë i/e saktë në mbledhje, përpunim dhe raportim të të dhënave.
- Asiston kolegët e tjerë në financa dhe operativ për mbledhjen e të dhënave.

Kualifikimet ;

- Diplomë në Fakultet Ekonomik/Biznesi – bachelor në drejtimet: Banka dhe Financa në Biznes.
- Përvojë në mbledhje, përpunim dhe raportim financiar.
- Njohja e punës me kompjuter.
- Njohja e pakos Microsoft Office, posaçërisht puna me Excel.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera të punës në grup, komunikim motivues në grup.
- Të jetë i përgjegjshëm/me, integritet dhe besim personal.

Pozita 4. Inxhinier i mekanikes (1 (një) pozitë pune)

Kohëzgjatja e punës: 3 vite me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitë, identifikon, vlerëson, kontrollon, bën analiza të punës për ngritje të efikasitetit dhe cakton orarin e punës në Sektorin e Mirëmbajtjes.
- Jep udhëzime dhe mbanë përgjegjësi në mirëmbajtje të autobusëve, për punën që duhet të kryhet brenda orarit të punës.
- Raporton te MTO me shkrim për defekter të cilat janë paraqitur, shkaku dhe dëmtimeve të autobusëve, apo i automjeteve tjera motorike të TU.
- Është përgjegjës për gjendjen teknike të autobusëve dhe automjeteve tjera, përcjellë pasqyrat mujore të harxhimeve të karburanteve (naftës, vajit, ad-blui, etj), të pjesëve rezervë, gomave dhe regjistrimin e kilometrave të kaluara.

Kualifikimet

- Të ketë diplomë nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në njërën nga drejtimet: Prodhimtari, Konstruksion apo Termo-energjetikë. Inxhinier i Diplomuar i Makinerisë apo Master i shkencave Teknike është me përparësi.
- Njohuri dhe profesionalizëm dhe qasje moderne me ide, planifikim dhe kontroll.
- Përvojë pune duhet të ketë së paku 3 vjet në fushën e automjeteve.
- Njohja e gjuhës angleze është obligative.

Pozita 5. Monitorues i kamerave dhe GPS-ve (1 (një) pozitë pune)

Kohëzgjatja e punës: 1 vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Monitoron, kontrollon dhe r'i mirëmbajë kamerat dhe GPS-ar në autobusë.
- T nxjerrë raportet, problemet të cilat paraqiten gjatë orarit të operimit dhe i ruan ato nga kamera dhe GPS.
- Kujdeset për servisim dhe mirëmbajtje të kamerat dhe GPS-ve.

Kualifikimet

- Shkollim i lartë TIK, Menaxhment dhe Informatikë ose të ngjashme nga fushat teknike.
- Aftësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet kompjuterike me kamera dhe GPS.
- Njohja e gjuhës angleze është obligative.
- Njohja e gjuhës serbo-kroate është me përparësi.
- Përvojë pune duhet të ketë së paku 3 vjet.

Pozita 6. Automekanik i autobusëve (1 (një) pozitë pune)

Kohëzgjatja e punës: 3 vite me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Pas pranimit të detyrave nga eprori/inxhinieri i mekanikes, duhet të angazhohen në kryerjen e detyrave për riparimin e autobusëve që janë në pritje për riparim duke u bazuar në urdhëresa të punës.
- Ngarkohet me pjesë dhe vegla pune, të cilat i ka kërkuar nga depoja si dhe pajisje të tjera, duke respektuar procedurat e pranimit – dorëzimit.
- Me inxhinierin riparon dhe merr pjesë të drejtpërdrejt në riparim dhe identifikon problemin e autobusit, të gjitha punët e kryera duhen të përcillen me proceduar përkatëse,

Kualifikimet

- Shkollim i lartë ose i mesëm në drejtimin e makinerisë.
- Njohuritë të punës profesionale dhe i motivuar për punë.
- Njohja e gjuhës angleze dhe serbokroate do të jetë me përparësi.
- Përvojë pune duhet të ketë së paku 3 vite.

Pozita 7. Auto-çlektricitist i autobusëve (1 (një) pozitë pune)

Numri i pozitave: 1 (një)

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Pas pranimit të detyrave nga eprori/inxhinieri ose eksperti teknik, duhet të angazhohen në kryerjen e detyrave për riparimin e autobusëve me defekte të elektrikes, që janë në pritje për riparim duke u bazuar në urdhëresa të punës.
- Ngarkohet me pjesë dhe vegla pune, të cilat i ka kërkuar nga depoja si dhe pajisje të tjera, duke respektuar procedurat e pranimit – dorëzimit.
- Është përgjegjës për riparim të shpejtë dhe profesional të defekteve në lëmi të elektrikes në autobusët.

Kualifikimet

- Shkollim i lartë ose i mesëm në drejtimin për auto-çlektricitist.
- Përvojë pune duhet të ketë së paku 3 vjet si çlektricitist në riparim të veturave.
- Njohuritë të punës profesionale, njohja e kompjuterit (Word, Excel)
- Njohja e gjuhës angleze dhe serbo-kroate është me përparësi.

Pozita 8. Auto-llamarist (ngjyrosës) (1 (një) pozitë pune)

Kohëzgjatja e punës: 3 vite me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Bën riparimin e llamarinës së autobusëve dhe përgatitjen për ngjyrosje.
- Të jetë i aftë dhe me përvojë për saldimit të llamarinave dhe konstruksionit të autobusëve, me përparësi përvoja me disa metoda të saldimit.
- Ngarkohet me pjesë dhe vegla pune, të cilat i ka kërkuar nga depoja si dhe pajisje të tjera, duke respektuar procedurat e pranimit – dorëzimit.
- Është përgjegjës për riparim dhe me ngjyrosje të shpejtë dhe profesional të autobusëve.

Kualifikimet

- Shkollim i lartë ose i mesëm në drejtimin auto-llamarist.
- Përvojë pune duhet të ketë së paku 3 vite.
- Njohja e gjuhës angleze dhe serbo-kroate do të jetë me përparësi

Dokumentacioni i nevojshëm dhe mënyra e aplikimit:

Kandidati, duhet t'i dorëzojë këto dokumente në formë të skanuar në email: punesimi@trafikurban-pr.com; (kandidatët që aplikojnë për pozitën 6, 7 dhe 8, aplikacionet e tyre mund t'i sjellin edhe në kopje fizike në zyrë të N.P.K. "Trafiku Urban" SLLA, rr. Tahir Zajmi p.n. Prishtinë).

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>)
2. Letër motivuese.
3. Kopja e letërnjoftimit.
4. Certifikaten se nuk janë nën hetime – jo më të vjetër se 6 muaj.

Konkursi është i hapur nga data 20.04.2018 dhe përfundon më datë 04.05.2018 në ora 24:00

Telef. i kontaktit për konkursin është: **045/10 11 22** nga ora 08.00 deri 16.0 (e hënë – e premte)



Sot u mbushën 20 vite qëkur në një pritë serbe në Koshare re dëshmorë për të mos vdekur kurrë

Veli Noci

Veli Ti mbetesh për jetë në kujtimet tona.

Je i pavdekshëm!

Je uragani i maleve tona për liri!

Të përkujtojnë: Babai Ademi, Nëna Nuri, gruaja Drita me fëmijët.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Gafur Ahmetaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Dëshmorët e Kabashit" Korishë

N.Sh "Glamour In" shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër: 71188582 dhe nr fiskal: 601295414

► Urgjentisht kërkohet një garsoniere për blerje në Fushë Kosovë. Çmimi 20.000 euro. Informatat në tel: 049 472 770

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do loj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshohet me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxejje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmeri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333